



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XII i botimit, nr. 145, nëntor 2015

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

KOMUNIKATË Nr.3

Të nderuar anëtar e anëtare të Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”!

Të nderuar dukagjinase e dukagjinase kudo që ndodheni!

Të nderuar miq e mikeshë të Dukagjinit dhe të Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, të historisë dhe kulturës së kësaj krahine emër madhe!

Kemi rreth një vit që po komunikojmë bashkë në forma të ndryshme që mundëson largësia, koha dhe mjetet e e shumta të komunikimit social. Kemi pasur kënaqësinë e bashkëbisedimit të hapur. Kemi pasur bukurinë e sinqeritetit midis nesh, kemi pasur harmoninë e të kuptuarit të njëri tjetrit. Gjatë këtyre bashkëbisedimeve, kemi shprehur mendime, kemi mbajtur qëndrime dhe më në fund kemi marrë vendime mjaft të rëndësishme në shërbim të krahinës së Dukagjinit, të historisë dhe kulturës së tonë, kemi marrë parasysh vështirësinë e realizimit të detyrave që kishim përpara, por, dhe kemi pasur kënaqësinë e realizimit të atyre detyrave që i kemi vënë vehtes...

GJERGJ KASTRIOTI - SKËNDERBEU ËSHTË NJOHUR SI MBRET I SHQIPËRISE QË NË VITIN 1458

- FAKTE QË PUBLIKOHEN PËR HERË TË
PARË -

NGA: Violeta Murati

Vatikanit zbulon një dëshmi sekrete të historisë shqiptare.

Për herë të parë del në dritë dokumenti ku është shpallur Skenderbeu mbret. Një akt diplomatik, mandat, në të cilin emerohet Martin Muzaka ambasador i Skenderbeut. Është një letër origjinale në pergamen me një vule shtetërore të varur, që ruhet në Arkivin Sekret të Vatikanit në fondin Miscellanease, volumi XXXIX, dokumenti 2398, nga viti 1458. Pikërisht në këtë mandat Skenderbeu quhet “mbret”. Ka qene dr. Musa Ahmeti një hulumtues i ka kohshëm i arkivave të Vatikanit që ka publikuar disa ditë më parë, në internet, mandatin e mbretërisë shqiptare.

MUZIKA QYTETARE SHKODRANE, KRYEVEPËR E TRASHËGËMISË KULTURORE ORGANIZOHET EDICIONI I TRETË I “MUZIKA QYTETARE SHKODRANE”

Në Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, me datën 29 shtator 2015, dite e Marte, ora 19. 30 ne mjediset e Muzeut Historik i Shkodres, në një mbrëmje të vërtetë festive, përmes një orkestrimi perfekt startoi me plot hijeshi e freski, tinguj e ngjyra, koncerti i muzikës qytetare Shkodrane-2015”, ...

Gegët e Malësisë së Veriut

Carleton Stevens Coon (1904 -1981). Është një antropolog amerikan, profesor i Antropologjisë në Universitetin e Pensilvanisë, pedagog dhe profesor në Harvard, dhe president i Shoqatës Amerikane të antropologëve. Malet e gjigantëve, ose Gegët, është një nga studimet e tij të rracave dhe kulturave të Maleve të Shqipërisë së Veriut

VATË SOKOLI BËN TË MUNDUR NGRITJEN E FLAMURIT SHQIPTAR NË BRUKSEL

Kisha dëgjuar nga disa të afërm në Bruksel se që nga vitin 2004, në çdo 28 Nëntor ngritet Flamuri Shqiptar në Bruksel. Ishte një ngjarje mjaft e mirë. Dhe, për ne, ka një veçori sepse është punë e një intelektual dukagjinase, Vatë Sokoli, i cili banon familjarisht në Bruksel prej disa vitesh. Kjo ngjarje me shumë rëndësi tregon se kudo ku janë intelektualët shqiptarë janë shumë të interesuar për simbolet e kulturën tyre kombëtare.



PËR MË SHUMË HAPËSIRË...

- MË SHUMË HAPËSIRË, O VËLLA, O MIK, O POLITIKË,
SEPSE DO TË KEMI MË SHUMË DRITË, O VËLLA, O MIK, O POLITIKË -

Kur je midis malesh me grupe rrugëtarësh, njerëz të rastit, bashkërrugëtar ose takime me drejtime të ndryshme, veçanërisht në vende të thyera malore, apo edhe në zona të tjera më të buta, por të largëta nga zonat urbane, shpesh dëgjon shprehjen “...të bukura por, të vështira për të jetuar” në këto vende. Në vështirimin e parë mund t’u jepet e drejta mendimit të tyre, por kur analizon me qetësi dhe me thellësi, nuk do të mbetesh me atë mendimin sepse njerëzit kanë nevojë për hapësirë që të jetojnë më mirë. Hapësirën, dritën, lirinë e kërkimit, iniciatori, ai që jo radhë merr parasysh edhe vështirësitë, rrezikun, për ti përballuar. Hapësirën e çdo gjallesë...

DASHURI E MIRËNJOHJE PËR VENDLINDJEN BASHKËBISEDIM ME AUTORIN E LIBRIT “DUKAGJINI-SHQIPËRIA IME ATY”, REFLEKSIONE, NDUE SANAJ, KRYETARI I SHOQATËS “ATDHETARE-DUKAGJINI”

Kohët e fundit, z. Ndue Sanaj, i mirënjohur, së paku, në mbarë Shqipërinë e Veriut për kontaktet e tij si publicistik, shoqëror, sa civil si njëri nga ideatorët themelues dhe po aq kryetar i shoqatës “Atdhetare-Dukagjini” dhe drejtues i gazetës “Dukagjini”, si një pasqyrim dhe inkurajimi vlerash, të cilat rritin nga dita në ditë autoritetin profesional, social dhe civil të shoqatës në fjalë, del para lexuesit me një tufë refleksionesh si përjetësim i të parit libër publicistik, titulluar “Dukagjini-Shqipëria ime aty”.

KOMUNIKATË Nr.3

Të nderuar anëtar e anëtare të Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”!

Të nderuar dukagjinas e dukagjinase kudo që ndodheni!

Të nderuar miq e mikesha të Dukagjinit dhe të Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, të historisë dhe kulturës së kësaj krahine emër madhe!

Kemi rreth një vit që po komunikojmë bashkë në forma të ndryshme që mundëson largësia, koha dhe mjetet e e shumta të komunikimit social. Kemi pasur kënaqësinë e bashkëbisedimit të hapur. Kemi pasur bukurinë e sinqeritetit midis nesh, kemi pasur harmoninë e të kuptuarit të njëri tjetrit. Gjatë këtyre bashkëbisedimeve, kemi shprehur mendime, kemi mbajtur qëndrime dhe më në fund kemi marrë vendime mjaft të rëndësishme në shërbim të krahinës së Dukagjinit, të historisë dhe kulturës së tonë, kemi marrë parasyshtë vështirësinë e realizimit të detyrave që kishim përpara, por, dhe kemi pasur kënaqësinë e realizimit të atyre detyrave që i kemi vënë vehtes.

Edhe këtë radhë po komunikojmë bashkë, duke ju njoftuar se detyrën e madhe, për shoqatën tonë, të nisur mbi dy vjet më parë, dhe të shpallur më 02 dhjetor 2014, në një Thirrje të hapur për të gjithë, ja, e realizuam me sukses të plotë; u ngritën shtatoret e atdhetarit Mehmet Shpendit më 16 korrik 2015, dhe albanologut Martin Camaj më 15 tetor 2015, në qytetin Shkodër. Është kënaqësi për të gjithë ata që njohin jetën dhe veprën e Mehmet Shpendit dhe Martin Camajt, që të shohin dhe ta dinë se janë vendosur aty ku e meritonin, ndoshta prej kohësh. Është kënaqësi edhe për të gjithë qytetarët e Bashkisë Shkodër për këtë dhuratë të madhe dhe të bukur. Është detyrë, por edhe kënaqësi, që, me rastin e përmbylljes më sukses të kësaj nisme, të falnderojmë të gjithë ata, emër për emër, që mundësuan me vlera monetare për realizimin e këtyre dy shtatoreve, por edhe ata që na ndihmuan me vendimet, me këshillat e ëmbla, miqësore dhe të vlefshme për të arritur në përrurimin e tyre. Duke plotësuar kërkesën e shumicës së dhuruesve, më të fuqishëm, për të mos publikuar llogarinë personale për secilin, kemi nderin të publikojmë sasinë në përqindje të kontribuesëve për këto shtatore, sipas grupimit të tyre: *1. Komuniteti shqiptar në New Jork - 61%; 2. Dhurues në dhe nga Shqipëria - 17%; 3. Komuniteti shqiptar në Miçigan - 15%; 4. Shoqata Malësia e Madhe - 4%; 5. Komuniteti Dukagjinas në Bruksel - 2%; 6. Shoqata “Vatra” në Miçigan - 1%.* Gjithashtu po publikojmë emrat e të gjithë dhuruesve me këtë rast sipas grupimit të mësipërm:

Komuniteti shqiptar në Neë Jork:

1. Ndoc Zefi Simolacaj
2. Gjeloš Kola
3. Tom Balbona
4. Dede Prendaj
5. Vat Biga
6. Familja Tonaj
7. Pal Balbona
8. Tom Rrethaj
9. Nikoll Nikgjonaj
10. Luk Toma Smajlaj
11. Paulin Troshani
12. Ndue Pal Luli
13. Zef Gjoku Gjellaj
14. Pal Krasniqi
15. Hil Krasniqi
16. Gjeto Bregu
17. Sokol Kukaj
18. Daniel Previzi
19. Martin Leka
20. Broz Shllaku
21. Gjin Radohina
22. Alban Kaçaj
23. Agim Marku
24. Ndue Slora
25. Pëllumb Çeka
26. Marjan Preçi
27. Arjanit Simoni
28. Luçian Kiri
29. Mark Mici
30. Mark Dreni
31. Sokol Kodra
32. Gjovalin Kroni
33. Nush Noli Gjellaj
34. Mirash Noli Gjellaj
35. Pal Noli Gjellaj
36. Gjon Sokol Gjela
37. Familja e Kol Nolit Gjellaj
38. Ndoc Sukaj
39. Gjin Markaj
40. Lin Kumbulla
41. Kole Camaj
42. Kujtim Funiçi
43. Familja e Gjergj Vocrrit
44. Familja e Nik Marashit
45. Mark Rroku Gjellaj
46. Dod Preçi Curanaj
47. Marash Kol Vuksanaj

48. Nikoll Llesh Vuksanaj
49. Pashko Llesh Vuksanaj
50. Pjeter Llesh Vuksanaj
51. Simon Zefi Simolacaj
52. Vladimir Lpeja
53. Luc Gjonlekaj
54. Petrit Nika
55. Gjergj Ndoja Vataj
56. Paulin Lufaj me Vllazen
57. Tom Shabi
58. Arben Rexhepi
59. Erland Lisi
60. Gjon Baftia me Familje
61. Nua Kola Shalanin
62. Boris Fran V. Shalanin
63. Jozef Gjergj V. Shalanin
64. Shuk Balbona
65. Nik Gjergji Gjellaj & Levis Nika Gjellaj
66. Fran Frashnishta
67. Prel Balbona
68. Gilbert Radohina
69. Familja e Kol Mirit Dedevukaj
70. Mark Gjeloš Mirakaj
71. Sokol Smajli
72. Kujtim Mali
73. Petrit Demaliaj
74. Mark Lushi Shalanin
75. Agim Kole Shkambi
76. Nikë Carku
77. Martin Shpendi Gjellaj

Dhurues nga Shqipëria:

78. Kolë Çardaku
79. Martin Martini
80. Tomë Shpendi,
81. Lad Gjon Doda,
82. Fran e Prekë Preçi
83. Ndue Mhill Çardaku
84. Prekë Gilaj
85. Alfred Haxhari
86. Ndoc Selimi
87. Viola Shqau
88. Arjan Gjuraraj
89. Ndue Sanaj
90. Gjon Brushtulli
91. Fran Molla
92. Zef Lulash Sokoli
93. Viktor Cukeli

94. Fran Piniqi
95. Arjan Gjuraraj
96. Gjovalin Kroni
97. Prenda Mark Shpendi
98. Gjon Gilaj
99. Luigj Shyti
100. Luigj Mila
101. Bardhok Braci
102. Vuksan Kola
103. Ndok Marku
104. Prelë Milani

Kominiteti shqiptar në Miçigan:

105. Ndue Ftoni
106. Nikolin Shyti
107. Prel Marku
108. Luvigj Sterbyci
109. Kujtim Sterbyci
110. Gëzim (Gjergj) Plepi
111. Vangjel Shyti
112. Nik Zef Laloshi
113. Kol Kroj
114. Arben Sokoli
115. Petrit Sokoli
116. Pllumb Kulla
117. Gjovalin Gjellaj
118. Shkëlqim Suka
119. Viktor Milani
120. Fran Marku
121. Artan Gjoka
122. Angjelin Ndou
123. Eduard Aliko
124. Luçiana Ftoni
125. Jetmir Dedaj
126. Gjon Marku
127. Pashko Gjokaj
128. Mark Shkreli
129. Fran Gjokaj
130. Jozef Dedvukaj
131. Pal Shkreli
132. Kujtim Prendi
133. Tush Duhani
134. NdreK Lulashi
135. Ben Pellumbja
136. Kel Popa
137. Prel Popa
138. Lek Leci
139. Gjergj Jaku-Kosove
140. Nike Goxhaj

141. Ndue Duhani
142. Lekë Oroshi

Shoqata “M.Madhe” në Miçigan:

143. Lek Leci
144. Luigj Gjoka
145. Pjetër Stanaj
146. Pjetër Jaku
147. Petrit Camaj
148. Gjok Grishaj
149. Rush Dragu
150. Nikoll Hysaj
151. Gjek Gjellaj
152. Rita Gjellaj
153. Ded Beleshi
154. Gjovalin Kacorri
155. Paulin Gega
156. Gjin Piroli
157. Marjan Kolaj
158. Gjon Marku
159. Tun Musolli
160. Gjok Gojani
161. Jetmir Cigarja
162. Albe Çulaj
163. Martin Leka

Komuniteti Dukagjinas në Bruksel:

164. Lekë Gilaj
165. Vatë Sokoli
166. Lulash Piniqi
167. Sokol Ara
168. Altin Preka
169. Fran Stomici
170. Florian Stomici
171. Mark Cuni
172. Valentin Mici
173. Tonin Cardaku
174. Sadik Kapaj
175. Prelë Mraja
176. Nol Stani
177. Vatë Musa
- Shoqata “Vatra” në Miçigan:
178. Alfons Grishaj
179. Gjovalin Gega
180. Juljan Cefa
181. Agostin Cupi
182. Kujtim Qafa, Krye.Shoq. “Mirdita”

Faleminderit të gjithëve!

**KRYESIA E SHOQATËS
ATDHETARE “DUKAGJINI”**

Shkodër, më 30 nëntor 2015

Shoqata Atdhetare “Dukagjini” disponon të gjithë dokumentacionin e grumbullimit dhe pagesave të bërë për këto veprimtari, përson për përson dhe për çdo veprimtari apo objekt për të cilin kanë qenë planifikuar shpenzime.

Edhe një herë, Ju jemi mirënjohës të gjithë atyre që dhanë ndihmesën e tyre

për realizimit e kësaj detyre. Në veçanti, me shumë, respekt falnderojmë ata që ndihmuan me vlera monetare, e ky falnderim, në radhë të parë, duhet të shkojë për komunitetin dukagjinas dhe shqiptar në Neë Jork të cilët mbuluan 61 përqind të shpenzimeve.

Arritja së bashku e këtij objekti të

Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” na ka krijuar më shumë besim, ka shkundur nga përgjumja dhe ka ngritur më lart ndjenjën atdhetare të gjithë komunitetit tonë, dhe gjithë dashamirësëve të Dukagjinit.

Urojmë që të takohemi edhe në të ardhmen në veprimtari dhe realizime për të mirën e krahinës dhe vendit.

GJERGJ KASTRIOTI - SKËNDERBEU ËSHTË NJOHUR SI MBRET I SHQIPËRISE QË NË VITIN 1458

- FAKTE QË PUBLIKOHEN PËR HERË TË PARË -

NGA: Violeta Murati

Vatikani zbulon një dëshmi sekrete të historisë shqiptare.

Për herë të parë del në dritë dokumenti ku është shpallur Skenderbeu mbret. Një akt diplomatik, mandat, në të cilin emerohet Martin Muzaka ambasador i Skenderbeut. Është një letër origjinale në pergamen me një vule shtetërore të varur, që ruhet në Arkivin Sekret të Vatikanit në fondin Miscellanease, volumni XXXIX, dokumenti 2398, nga viti 1458. Pikërisht në këtë mandat Skenderbeu quhet “mbret”. Ka qene dr. Musa Ahmeti një hulumtues i ka kohshëm i arkivave të Vatikanit që ka publikuar disa ditë më parë, në internet, mandatin e mbretërisë shqiptare.

Si u gjet vula e mbretit

Hulumtimet nëpër arkiva e biblioteka të ndryshme, kanë mundësuar zbulime të reja të këtyre akteve, për të cilat më parë është menduar se janë zhdukur apo nuk kanë ekzistuar fare. Duke u nisur nga këto hulumtime, të kohëve të fundit (viti 2000)], studiuesi nga Zagrebi, Ahmeti, në Arkivin Sekret të Vatikanit në Vatikan, në fondin Miscellaneae, nga viti 1458, zbulon një mandat (akt diplomatik) origjinal të Skenderbeut, me të cilin emerohet Martin Muzaka si përfaqesues i tij “legjitim dhe legal”.

“Dokumenti është i shkruar në pergamen. është ruajtur mjaft mirë”, pohon Ahmeti. Dokumenti ka dimensione: 68 x 92.5 cm. Në të janë varura edhe dy vula origjinale. E para vula shtetërore e Skenderbeut dhe e dyta ajo e notarit Johannes Borcius de Grillis. “Ne na është bërë e njohur edhe një kopje e këtij mandati që ruhet po ashtu në Arkivin Sekret të Vatikanit, në Vatikan në Fondin: Diversa Cameralia, vell. 30, f. 134r-v. Kjo kopje është e saktë dhe tepër besnike, pa asnjë leshim nga ana e përshkruesit”, pohon studiuesi Ahmeti.

Kur u be Skenderbeu mbret?

Ishte zgjedhur Rodoni, në jug të Shqipërisë, për të nënshkruar mandatin e mbretit. Siç shënohet nga origjinali, mandati është lëshuar me 28 tetor të vitit 1458.

I drejtohet papës Piu i II-te, i cili kishte më pak se dy muaj që kishte filluar pontifikatin e tijë (Piu i II-te fillon pontifikatin me 3 Shtator të vitit 1458 dhe vdes me 15 gusht 1464). “Papa Piu njihej si luftëtar i rrepte për mbrojtjen e fese së krishtere edhe sa ishte cardinal”, shkruan studiuesi Ahmeti.

Një moment tjetër i rëndësishëm që tërheq vëmendjen te ky mandat është edhe pohimi i notarit publik Johannes Borcius de Grillis se ai “me urdher dhe autorizim të mbretit...” do me thën. Skenderbeun e quan Mbret.

“Ky moment është tepër domethënës

ngase edhe në vulën shtetërore të varur që e shoqëron këtë dokument e gjejmë të shkruar tekstin: Sigill (um)o Regni(ae) o Macedonia(e)o et oAlbania(e) që në gjuhën shqipe do te ishte: Vula e Mbretërisë së Shqipërisë dhe Maqedonisë”.

Skenderbeu trashëgon zyren nga i ati,



Gjoni

Nga dokumentat mendohet që zyra kancelarike që ishte pranë Skenderbeut të ishte vazhdimësi e të njëjtës zyre, e cila funksiononte te i ati Gjon Kastrioti.

Sipas Ahmetit, flitet që kjo zyre daton në shekullin XIV dhe fillimi i shekullit XV.

“Natyrshisht që kancelaria e Skenderbeut ishte shumë më moderne dhe ju ishte përshtatur rrethanave dhe kohës kur vepronte. Sipas hulumtimeve të bëra, kemi ne dorë një të dhënë tepër interesante, se nga zyra e Skenderbeut, ka ndodhur që mbrenda një dite të nxirren 13 akte të ndryshme diplomatike, të shkruara në 5 gjuhë. Kjo e dhene tregon se cili ishte komunikimi i Heroit tonë kombëtar me shtetet tjera mjesjetare dhe me fqinjët, si dhe roli shumë i rëndësishëm që luante kjo diplomaci ruajtjen e pavarësisë shtetërore dhe teritoriale”, shpjegon studiuesi Ahmeti.

Historia e kancelarive shqiptare

Gjatë mesjetës, sundimtaret dhe princerit shqiptarë kishin zyrat e tyre te kancelarive në nivele të ndryshme si notere, sekretare apo perkthyes.

Këto zyra ishin mjaft te zhvilluara dhe mund të rënditen në radhën e kancelarive të ngjashme më të njohura, në Evropë, gjë që tregonte për nivelin e lartë të zhvillimit dhe kujdesit që tregonin sunduesit shqiptarë në komunikim me sundimtaret tjerë.

Nga këto zyra dolen akte, diploma, mandate dhe dokumente nga më të ndryshmet, në disa gjuhë që në atë kohë ishin në përdorim zyrtar.

Porse deri më sot ka pak njohur të mbledhura dhe që ekzistojnë për këto dokumenta orgjinale. Pjesa dermuese e tyre siç duket janë zhdukur përgjith-

monë, pjesa tjetër pret hulumtuesit që ato ti nxjerrin në dritë dhe ti botojnë, Ndërsa vetëm në këto vite po hyhet në këtë mister dëshmish historike ku disa fakte të zbuluara rishtazi. Sipas studiuesit Ahmeti, karakteristike e përgjithshme e këtyre akteve të botuara është se ato nuk ndryshojnë nga ato te sundimtareve të

Në nëntor të vitit 2007, pra 8 vjet më parë, Shoqata “Atdhetare-Dukagjini” dhe Shoqata “Integrimi European”, mbështetur në disa të dhëna historike mbi jetën dhe veprën e Gjergj Kastriotit – Skënderbeu, dhe mbi mundësinë e dekretimit të tij mbret i Shqipërisë dhe më gjerë, i janë drejtuar Papa Benediktit të XVI, për konfirmimin e këtij dekreti, i cili mbeti pa u dorëzuar në ceremoninë që ishte planifikuar të bëhej në Shqipëri, por nuk u bë e mundur nga vdekja e pa prituri e Papa Piu i II.

Në këtë numër gazete po botojmë një studim të bërë dhe publikuar kohët e fundit nga Musa Ahmeti dhe përgatitur për botim nga Violeta Murati-
Redaksia e gazetës “Dukagjini”

tjerë, fqinje apo evropiane.

Zakonisht në këto kancelari janë përdorur gjuhët kulturore të kohës si: latine, greke, sllave, italizane osmane dhe ndonjë tjetër.

Ndërsa ende nuk ka asnjë dokument që është shkruar në gjuhën shqipe nga aktet noteriale.

Hidhet poshte datimi i studiuesve shqiptare

Permbysjet një nga datimet e nxjerra nga studiuesit shqiptarë. Me zbulimin e mandatis të Skenderbeut nga Arkivat sekrete te Vatikanit, hidhet poshtë data e shkruar deri më tani për këtë document. Viti 1463 e vënë nga studiuesit shqiptarë nuk vlen më.

Kjo date thuhet se është vendosur pa pasur në dorë dokumentin, as origjinalin dhe kopjen. Ndaj argumentohet gabim ky datim. Me daljen e mandatin të Skenderbeut nga Vatikani kjo datë kalon rreth pesë vite më përpara, pra në vitin 1458, pra koha kur Gjergj Kastrioti shpallet mbret. Siç vërehet nga origjinali, mandati është lëshuar në Rodon të Shqipërisë me 28 tetor të vitit 1458.

I drejtohet papës Piu i II-te, i cili kishte më pak se dy muaj që kishte filluar pontifikatin e tijë (Piu i II-te fillon pontifikatin me 3 shtator të vitit 1458 dhe vdes me 15 gusht 1464) dhe njihej si luftëtar i rrepte për mbrojtjen e fese së krishterë edhe sa ishte kardinal.

Perkthimi ne gjuhen shqipe i mandatis nga viti 1458

Mandati i Skenderbeut për Papën

Duke qenë se kohë më parë jemi njofuar nga raporti i Martin Muzakës, këshilltarit dhe oratorit (zedhensit) tonë, të cilin, kohë më parë e kemi dërgue të shenjterisë dhe fortlumturija e Tijë Hyjnore, papë Piu

i II-te; që shenjterisë e Tijë, papa ynë, duke u kujdesur për poziten e fese së krishtere, e cila është sulmuar nga fatkeqësia e njerzimit, tirani turk, Mehmeti (i II-te, m.a.) dhe bashkëluftarët e tijë, armiq të emrit, i krishterë; duke dëshiruar që të ndihmojë me shërbimin e tijë dhe t’iu vije ne ndihme forcave te tija; ka paralajmëruar, ftuar dhe shtytur nje numer te madhe te mbreterve të krishterë, që të ofrojnë shërbimet e tyre, për një vepër kaq të shenjte dhe të dobishme; dhe se duhet bërë këtë nga obligimi dhe pranimi i dobive që kanë ndaj fesë së krishterë; ka ftuar shumë mbretër të krishterë që të bashkohen personalisht ose duke dërguar përfaqesues të tyre me autorizime të plote-fuqishme dhe zyrtare.

Ne, Gjergj Kastrioti Skenderbeu, zot i Shqipërisë, si të krishtere të mirë, dëshirojme të rënditemi në mesin e atyre besimtarëve të krishtere, të permendur, duke u treguar besnike dhe shërbetorë të denje; emrojme të lartepemendurin,

Martin Muzaken, të i cili kemi besim të pakufishëm dhe kofidencë, për legalitetin e tij ndaj nesh, eksperiencën, ndershmërinë, zotësinë dhe përgatitjen e lartë intelektuale, pikërisht të njëjtin, Martin Muzakën, e vemë, përcaktojmë dhe autorizojmë që sipas permbajtjes së këtij mandati të jetë oratori (zedhënësi) dhe përfaqesuesi yne legjitim dhe legal, që në emër tonin dhe për ne të paraqitet pranë të lartecekurit, shënjtërisë së Tijë, papës tonë dhe para shumë të nderuarit Kolegj te Kardinaleve, në Kongregacionin e permendur, dhe me mbreterit tjera apo me oratorët (zedhënësit) e tyre, aty, për të njëjtën problematikë (temë) ose për ndihmë fesë sonë të shenjtë, e cila në të shumten varet nga ata, për nder dhe emër të Zotit, të debatojë, të bisedojë, të japë mendim, të shqyrtojë dhe të nxjerr përfundime, që do të ishin në favor të një ndermarrje të tillë ose të bënte çdo gjë që është e mundur, duke pohuar, sajuar, bashkuar, mbledhur ose konkluduar, për një veprim të tillë, në emër tonin dhe për ne, të marr obligime duke treguar atë që është për tu lavdëruar, lejuar dhe zbatuar, çka do të pranonin të gjithë të pranishmit, por edhe individualisht, dhe përsa ka të bëjë me ne, ose sa do te kishte të bënte me ne, si dhe për personalitetin tone, më të mirat tona, tokën tone, qytetet tona të fortifikuara, vendbanimet tona, keshtjellat tona dhe ne popullin tone, besnikët tonë të armatosur, ne njerzit tonë, pjesërisht apo në tersi, për të mbrojtur fenë e krishtere dhe ne dem të armiqëve tonë të permendur, siq do të vërehet edhe nga mandati ynë i hapur, të cilin e dergojmë, dhe si mund të konkludohet, që ligjërisht obligohemi, që me vulen tonë, (vijon në faqen 10)

VATË SOKOLI BËN TË MUNDUR NGRITJEN E FLAMURIT SHQIPTAR NË BRUKSEL

Kisha dëgjuar nga disa të afërm në Bruksel se që nga vitit 2004, në çdo 28 Nëntor ngrihet Flamuri Shqiptar në Burksel. Ishte një ngjarje mjaftë e mirë. Dhe, për ne, ka një veçori sepse është punë e një intelektual dukagjinasi, Vatë Sokoli, i cili banon familjarisht në Bruksel prej disa vitesh. Kjo ngjarje me shumë rëndësi tregon se kudo ku janë intelektualët shqiptarë janë shumë të interesuar për simbolet e kulturën tyre kombëtare.

Pak ditë më parë i kërkoja disa kujtime, shkurtimisht, zotit Vatë, të cilat po i paraqes në vijim, ashtu thjeshtë siç karakterizohet ai.

“Ka qenë pak ditë përpara Ditës së Flamurit në vitin 2004 kur vendosa që të kërkoj takim me Kryetarin e Komunës së Koelkalberg Zotin Filip Pivin në Bruksel, dhe më kujtohet që ishte ditë e martë kur më prit. Unë kisha vu re se para Komunës ndërroheshin flamurët e vendeve të ndryshme Europiane për çdo javë. Me vete mora edhe një flamurë shqiptar në çantë, që e kisha në shtëpi. Gjatë takimit i thashë së jemi një komunitet i vogël shqiptar në Komunën tënde dhe do të dëshironim që të na respektonit duke vënë flamurin tonë, këtu para komunës, me rastin e 28 Nëntorit, e cila është festa jonë kombëtare e cila vjen vetëm pas tre ditësh, sepse takimi u realizua me datën 25 nëntor të atë viti. Ai më njihte sepse kishte ardhur në kafënë tonë që



ndodhet para Komunës dhe shkëmbenim përshëndetje të rastit dhe sigurisht që kishte informacionet rreth familjes time.

Biseda, natyrisht, u shoqërua

edhe me një bisedë rreth historisë së këtij komunitetit shqiptar në Belgjikë, Bruksel dhe komunën e tij në këtë qytet ku ne banonim dhe që ishte komuniteti më i vjetër shqip-

tar se sa ishim ne, dhe ku i ati i tij kishte qenë 21 vjet me radhë burgmaestër dhe i biri, Filipi, me të cilin po bisedoja, ishte zgjedhur që në vitin 2000 (kishin krijuar dinasti), por kjo nuk ishte çudi në Belgjikë. Ai qeshi me propozimin tim, dhe për ti rënë shkurt, tha që flamurët që ndërrohen aty janë vetëm të Unionit European.

Me këmbënguljen time vendosi të konsultohet aty për aty me ministrin e jashtëm belg nëse do të përbente incident diplomatik po qe se vendosej flamuri ynë aty. Sipas atij ishte në të drejtën e Komunës ta pranojë ose jo në territorin e saj, dhe shtoi se “unë e mora vendimin pro” dhe mandej në radhën e ardhshme e miratoj në Këshillin e Komunës. Unë u emocionova shumë, sepse kisha pak shpresë, për këtë “po” dhe në këtë moment nxora nga çanta flamurin e palosur dhe e vura në tavolinë duke i thënë se, nuk kemi vetëm 3 ditë në dispozicion dhe po nuk u angazhuat personalisht nuk do të bëhet e mundur vendosja e tij këtë vit. Ai thirri aty në prezencën time personin e duhur dhe i dha porosinë. Unë kisha frikë ta publikoj me përjashtim të një rrethi të ngushtë njerëzish, duke menduar një mosrealizim të kësaj pune. Vërtetë me 28 Nëntor 2004 në ora 08.00 dy punonjësit që ndërrojnë flamurët, vunë flamurin shqiptar. Unë u emocionova pa masë, sepse po shikoja qysh në

orën 07.00 të asaj dite. Ishte hera e parë që flamuri shqiptar valëvitej para një institucioni shtetëror Belg, pastaj ju thash pjesëtareve të familjes dhe disa të tjerëve që kjo ngjarje ishte ndodhur.

Edhe burgmaestri (Filipi) erdhi, sipas premtimit që më kishte bërë me dy persona të tjerë (zëvendës të tij) në lokalin tonë, që në atë kohë quhej “Range et Noir” (Kuç e Zi) që koïncidentme me ngjyrat e flamurit dhe e përmendi si argument plus. Takimit në kafe tonë zgjati rreth dy orë. Që nga viti 2004, çdo 28 Nëntor, Flamuri Shqiptar valëvitet përpara kësaj Komune dhe festimet e shoqërojnë me përmasa të ndryshme”.

Me 28.11.2015, në ditën e Flamurit të Shqipërisë, me nismën e Vatës dhe djemëve të tij, dhe me lejen e autoriteteve vendore, “djali që urinon”, simbol i qytetit të Brukselit, u vesh me kostumin tradicional shqiptar. Kjo duket në foton e dytë. Në plan të parë Vata dhe ambasadorja e Shqipërisë në Bruksel.

Nuk ka sesi të mos ndjehesh krenar me intelektual të tillë, si Vatë Sokoli, që pavarësisht se ku jetojnë, nuk harrojnë vendin e tyre, datat përkujtimore, vlerat e traditat tona të vjera, nuk harrojnë vendlindjen, Shqipërinë.

Luigj Shyti

VJESHTË 2015, NË SHALË

- reportazh -

Shala është një krahinë që shtrihet në zemër të Alpeve nga Jezerca në Kodër-Shëngjergjit. Në dy anët e lumit të Shalës rrethuar nga vargmalet: Mali i Toplanës, Qafa e Agrit, Arshelli, Qafa e Ndëmajes, Majat e Thata, Denelli, Qafa e Valbonës, Alai e Jezerca në lindje dhe Mali i Shoshit, Suka e Kunorës, Qafa e Boshit, Biga e Gimajve, Qafa e T'throes, Radohina e Jezerca në perëndim. Luginës në formën e shkronjës ‘V’ bimësia e shumëllojshme dhe ujërat e rrjedhshëm që formojnë shumë kanjone të thella, i japin një bukuri madhështore të shumëdëshiruar nga turistët e huaj dhe vendas. Në veri të Shalës është i vendosur fshati Theth, në lindje fshatrat Lekaj, Abat, Pecaj, Nicaj e Vuksanaj, dhe në perëndim fshatrat Nderlyisë, Gimaj, Nënnavriq e Lotaj. Këto dy shpate lidhen me njëra-tjetrën nëpërmes disa urave si ajo e Shalës në Breg-Lumi mjaft e vjetër prej druri, e cila, fatkeqësisht, u zëvendësua me një urë hekuri ushtarake në vitin 1974 duke zhdukur kështu edhe një trashëgimi kulturore që lidhej edhe me shumë ngjarje historike. Sot, mbi lumin e Shalës funksionojnë 6 ura betoni e pasarella. Nga kjo krahinë kanë dalë burra dhe gra që kanë bërë emër në fusha të ndryshme, jo vetëm në zonë, por edhe në Shqipëri e Ballkan, sidomos për sa i përket kontributit historik në mbrojtje të tërësisë tokësore dhe pavarësisë së krahinës. Jeta ekonomiko-shoqërore në këtë zonë është e mbështetur në bujqësi e blegtori, në respektin e mirëkuptimin e

ndërsjellë, në gatishmërinë për ndihmën humane e respektimin e pronës së njëri-tjetrit. Para tridhjetë vitesh në këtë zonë banonin 5 000 banorë, ndërsa sot vetëm 200 banorë të përhershëm, ndërkohë që dhjetëra e dhjetëra banorë të tjerë dalin nga Shkodra në fillim të Pranverës për të punuar tokat e tyre e për të marrë prodhimet e mbara. Muajin e trete të Vjeshtës, këtu në Shalë, njerëzit po i japin dorën e fundit përgatitjeve për dimrin e gjatë e të vështirë, me ngrica e borë të shumtë që shkon në trashësi 0.5 deri në 3 metër, dukë bërë kështu edhe izolimin e zonës, madje edhe fshatrat nga fshatrat e shtëpitë nga shtëpitë. Pozicioni gjeografik i “dhuron” Shalës një dimër të gjatë prej tre-katër muajsh shpeshherë të shoqëruar edhe me dëme të mëdha në blegtori dhe pemët frutore. Në këtë muaj banorët grumbullojnë, sistemojnë e magazinojnë bazën ushqimore për bagëtitë, si sanën, kashtën e misrit, dushqet e thata të lisit, frashrit, bungut, verit e deri tek fieri që e përdorin për t’ua shtruar bagëtitë në dimër. Të gjitha këto i gjen pranë kasolleve (stallave të bagëtitë). Një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të ushqimeve për familjet e tyre, për periudhën e dimrit. Kotecet e misrit plot e përplot, gropat e patateve, të gështenjave, lakrave, rrepave, konservimi i zarzavateve, numri jo i pakët derrave për mish, bagëtitë e imta, shekat me djathë e gjizë të bindin për pragmatizmin dhe tradicionalizmin e përgatitjes se banorëve për t’u përballur me dimrin sido që të jetë ai. Koha shumë e mira i ka favorizuar këtë vit, ndaj

njerëzit janë në valën e punës, për të siguruar bazën ushqimore, drutë për ngrohje, riparimin e shtëpive e kasolleve dhe thaujse tek të gjithë dëgjon të njëjtën shprehje: “Faleminderës për këtë kohë të mirë që na dha mundësi të hyjmë të gatshëm për t’u përballë më dimrin!”. Në asnjërin prej fshatrave numri familjeve nuk e kalon shifrën 10-12. Kjo sjell vështirësi në komunikim dhe në përballimin e punëve që kërkon shumë fuqi punëtore si kanalet ujëtare, rrugët automobilistike (të cilat janë në gjendje skandaloze), riparimin e mullinjve që përdoren për bluarje, ndërkohë që në disa familje gjen edhe mullinj siç i quajmë “zjarri” që do të thotë me energji elektrike.

Në këto ditë të bukura nëntori, bëmë një vizitë në vendlindje. Në varrezat e të parëve tanë ndezëm qirin dhe vendosëm tufa me lule. Nderë e respekt për punën e tyre! Të paharruar qofshin për jetë! Në këtë prag dimri, natyra brenda natës ndërron “veshje” nga e kafënjtë e vapë në të bardhë e ftohtë, pasi bora vjen si mikeshë e stinës. Jo më kot populli thotë “Nata e dimrit është barsë”. Në këto kushte të habit një fakt: As pushteti vendor as pushteti qendror “nuk e kanë vënë ujin në zjarr” për të sjellë e magazinuar produktet më të domosdoshme ushqimore si vaj, makarona, sheqer, miell e shumë të tjera për këta banorë që përballen në mënyra titanike me dimrin vit për vit. Me sa duket kjo tashmë është kthyer në një monoton të përvitshme dhe askujt s’i bën përshtypje. Së shpejti Qafa e T’hores dhe Mali i Shoshit, si dy rrugët e vetme për të furnizuar banorët e kësaj zone, do të bllokohen nga bora e pastaj në mediat e ndryshme do të shohim pushtetarë që qajnë hallet e këtyre

njerëzve me lot krokodili, pastaj organizimin e tenderëve pa asnjë lloj konkurrence për hapjen e rrugëve e dërgimin e ushqimeve e si përfundim një kosto marramendëse dhe një shërbim shumë i keq për këta banorë do të jepet për pasojë të neglizhencës së tanishme. Ky është pushteti, gjoja i zgjedhur nga populli për t’i shërbyer atij. Ky është “përkushtimi” i turpshëm dhe detyrimi “skandaloz”ndaj votës që ua rrëmbyen me njëmijë e një mënyra! Me dreka e darka, me para e me premtime, me qurravitje maskarenjsh e përbetime hyjnore. Tashmë vota e tyre është marrë dhe përdoret vetëm e vetëm për të trashur pasuritë dhe zullumet e tyre.

Infrastruktura e lënë tërësisht në dorë të fatit, duket sikur nuk ekziston ndonjë sektor apo drejtori që e mbulon atë. Punëtorët nuk duken gjëkund, ndonëse rrogat i marrin çdo fund muaji. Sikur infrastruktura rrugore të ishte funksionale, nuk do të ishte ndonjë lodhje e madhe që bashkia të organizonte, të paktën njëherë në muaj, një treg ambulant shit-blerje në qendër të kësaj zone, pasi prodhimet e këtyre banorëve shpeshherë shkojnë dëm për mungesë të tregut, ose më e shumta blihen nga matrapazë të paskrupullt me çmime qesharake dhe shiten me shumëfishin e tyre në tregun e Shkodrës. Një problem, thaujse më jetësori, është ai i shëndetësisë. Nuk behet fjalë për një shërbim si të dikurshëm kur shërbenin pesë mjekë specialist, infermiere, mami, farmaci, por të paktën medikamentet më të nevojshme mjekësore duhet t’u afrohen këtyre banorëve. Ndërkohë mungon edhe mjeku edhe infermiera, edhe farmacia dhe nëse ilaçet janë, ato janë të skaduar. A nuk është jashtë çdo logjike, që në shekul-

lin e njëzetë e njëjtë të shërbehet në fushën e mjekësisë si në kohët prehistorike. Njerëz amator me empirizmin e tyre sfidojnë shtetin në këtë fushë, pasi ky i fundit është inekzistent në këto zona, dhe pavarësisht kësaj disa rroga të majme përfundojnë në xhepat e dikujt. Në kushtet e izolimit total nga dimri, njerëzit e kësaj zone improvizojnë si dikur të quajturin “vig” për të transportuar të sëmurët në drejtim të spitalit të Shkodrës. Këto zona kanë nevojë për më shumë kujdes social e ekonomik, veçanërisht me fonde e kredi të buta për të nxitur prodhimet bujqësore, blegtorale e ato të frutikuturës, sidomos gështenjë dhe dhisë, pasi iu përshtaten edhe kushteve klimaterike të zonës. Çdo gjë e mirë që është bërë në këtë zonë në këto njëzet e pesë vite mban vullën dhe dorën e iniciativës private të këtyre banorëve, se sa për shtetin rrënim i do të ishte akoma më i trishtuar. Rikonstruksioni i ndërtesave, ndërtimet e reja, përpjekjet për të qenë bashkëkohës, mikpritja e këtyre banorëve e ndërthurur me bukuritë natyrore kanë bërë të mundur tërheqjen e qindra turistëve vendas e të huaj. Kjo zonë ka nevojë për ndihmën e shtetit e jo për lëmshën e tij. Për të gjithë banorët e përditshëm, për të gjithë të larguarit në qytet, brenda vendit e jashtë shtetit dua të përmend fjalën e urtë popullore: ‘Gomarini e nxjerr l zoti nga balta!’ Ky vend ka një emër ... ka një emër të mirë. Quhet Shalë. Kushdo t’ia kthejë lavdinë, gëzimin, lumturinë e gjallërinë që e meriton? Shaljanët dhe vetëm shaljanët!

Përgatitë nga Zef Fusha, nëntor 2015

PËR MË SHUMË HAPËSIRË...

- MË SHUMË HAPËSIRË, O VËLLA, O MIK, O POLITIKË, SEPSE DO TË KEMI MË SHUMË DRITË, O VËLLA, O MIK, O POLITIKË -

Kur je midis malesh me grupe rrugëtarësh, njerëz të rastit, bashkërrugëtar ose takime me drejtime të ndryshme, veçanërisht në vende të thyera malore, apo edhe në zona të tjera më të buta, por të largëta nga zonat urbane, shpesh dëgjon shprehjen “...të bukura por, të vështira për të jetuar” në këto vende. Në vështirimin e parë mund t’u jepet e drejta mendimit të tyre, por kur analizon me qetësi dhe me thellësi, nuk do të mbetesh me atë mendimin sepse njerëzit kanë nevojë për hapësirë që të jetojnë më mirë. Hapësirën, dritën, lirinë e kërkon guximtari, iniciatori, ai që jo radhë merr parasysh edhe vështirësitë, rrezikun, për ti përballuar. Hapësirën e kërkon çdo gjallesë. Për më shumë hapësire u ngjiten në ato male të bukura e krenare, por shumë të vështira për ti përballuar, paraardhësit tonë. Patën shumë vështirësi nga të gjitha drejtimet, por jetuan në lirin e tyre të kërkuar, në atë liri që nuk mund ta kishin në zonat ku ishin më herët. Jetuan si shqipet të cilat kërkojnë hapësirë, dritë, liri.

Koha ecën, madje vrapon, dhe erdhi momenti i lëvizjeve të mëdha të viteve të fundit, i kërkimit të hapësirës, dritës e lirisë sipas dëshirës. Nga një mbyllje dhe shtrëngim i madh i lëvizjeve, për një kohë të gjatë, dolëm në një hapje dhe liri të madhe, madje edhe në mënyrë të pakontrolluar, në një liri lëvizjeje për një jetë më të mirë, për më shumë hapësirë, për më shumë dritë. Në këtë kërkim të hapësirës dhe dritës u drejtua pjesa më jetësore e popullit tonë, shumë kërkuar nga fituan, e, jo pak, fatkeqësisht nuk do të kthehen më, sepse jeta e tyre është sosur, është këputur, diku, në ndonjë rrugë, në ujë, nën muret e ndonjë ndërtese, nga ndonjë plumb “qorr”, nga ndonjë hekur i ndryshkur por vrastar, apo diku tjetër, ka shumë ndoshta, edhe pa adresë, dhe pamundësinë për ti vënë të afërmit një tufë lule te guri i varrit. Gjithsesi hapësira është domosdoshmëri.

Hapësirat e kërkuara janë domosdoshmëri edhe për integrimin në mjediset e reja ku u vendosën ata që lëvizën nga vendlindja, vendbanimi tradicional. Vetë integrimi është hapësirë, sepse po mungoj kjo mungon edhe ai. Integrimi si fenomen ka të bëjnë me të integruarit dhe integruesit. Është një marrëdhënie e dyanshme, e atyre që kërkojnë integrimin dhe e atyre që duhet të punojnë për ti integruar. Ulja e përbashkët në një tavolinë, në një sofër, bëra vend për secilin sipas mundësive dhe aftësive, krijon hapësira që janë jo vetëm të nevojshme, por të domosdoshme. Sot për këtë hapësire, në mënyrë të arsyeshme dhe të vazhdueshme, kemi nevojë. Për hapësira bëhen lëvizjet e mëdha. Është detyrë morale e shoqërisë që të ndihmojë integrimin e grupeve të ndryshme të popullsisë, asaj që ka lëvizur dhe asaj që është gjetur aty. Të dy palët kanë detyrë të ndihmojnë, nuk mund të themi se cila më shumë, por duhet të kuptohet se që të dyja kanë nevojë për njëra tjetrën, madje shumë.

Shoqëria njerëzore, mbase sot më shumë se kurrë, ka nevojë për krijimin e hapësirave në marrëdhëniet shoqërore, pa të cilat nuk

mund të kenë zhvillimin e demokracisë dhe përparimit. Mungesa, ose mbyllja e hapsirave mund të çojë, si në jo pak raste në të kaluarën, në ballafaqime të paparashikueshme që shoqërisë njerzore mund ti kush-tojnë shumë shtrenjtë.

Çështja e krijimit të hapësirave nuk është ndonjë pamundësi e madhe, por kërkon pak durim, mirëkuptim, ndërgjegjësim dhe tolerancë, të cilat është e mundur që të arrihen. Krijimi i hapësirës së nevojshme, dhe të domosdoshme, natyrisht, fillon që tek individ, familja, grupi shoqëror, bashkëpunëtorët, eprorët dhe vartësit, punëdhënësit dhe punëmarësit, shteti dhe komuniteti, ligji dhe morali. Pak hapësirë kërkohet edhe në caktimin dhe kryerjen e një detyre. Nuk ka hapësirë kur dikush kërkon që ti kryej të gjitha punët vetë. Nuk ka hapësirë kur “të gjithë duhet të marrin frymë përmes gabzerrit (fytit) të njerit”. Mungon hapësira kur ekziston mosbesimi. Mungon hapësira kur vendoset tutela. Mungon hapësira kur mohohet puna e njerit, apo tjetrit, dhe ngrihet lart dikush me më pak punë, thjeshtë mbi bazën e marrëdhënieve të çastit e simpatisë personale. Mungon hapësira kur vendoset në krye të vendit kalorsi për hirë të kalit. Mungon hapësira e duhur kur pa marrë vendimet dhe masat për një punë, të publikohet për popullaritet, sipas idesë “pa bërë punën për të marrë shpërbëlimin”. Nuk ka hapësirë kur vraponet për të publikuar veprime që të mund të merret ajo çfarë mund të merret, sipas idesë “po publikoj i pari që të dal i pari”, pavarësisht se kush ka dhënë mendime, është lodhë, ka qëndruar edhe pa gjumë, ka prodhuar ide, etj. etj. Mungon hapësira kur nuk i kushtohet kujdes dhe vëmendje punës, ose kur ka më shumë reklamë se punë, qofshin persona të veçantë apo grupe shoqërore, OJF, etj. Këtu nuk përjashtohet as shteti. Kur mungon hapësira mungon edhe drita. Dhe kur kjo mungon, çfarë nuk mungon atëherë. Mungon hapësira kur mungon dorëheqja kur ka ose dalin probleme që duhet gjykuar, ose duhet punuar më mirë, kur duhet dorëheqja për t’i liruar vendin atij që e meriton, që punon më mirë, është më i aftë. Mungon hapësira kur nuk i hapet rrugë drejtësisë, por edhe kur drejtësia nuk jep drejtësi, sepse kur zbatohet ligji për të gjithë nuk mbetet i pakënaqur askush. Ndoshta drejtësia është rregullatori shoqëror i të gjithë hapësirave për të pasur më shumë dritë, e nga kjo do të jenë më shumë zhvillim e përparim, madje unë mendoj se ajo është pa “ndoshta” fare.

Mungon hapësira kur biseda midis shokësh e miqësh, serioze dhe me qëllim të mirë, dhe pa përfunduar asgjë, të bëhen biseda kafenesh, me këdo e kurdo, me keqdashje, pse jo edhe për të përgatitur terrenin për kundërshti. Kjo me sa duket bëhet për të ulur vlerat e kolegut, shokut, mikut, bashkëbiseduesit, sepse edhe e vërteta kur thuhet dhe përdoret vend dhe pa vend merr karakterin e thashtehemeve, denigrohet, zbehët, zhvlerësohet, i hiqet mbështetje.

Duhet krijuar pak hapësirë edhe atyre që i ke marrë përdore dikur, kur ishin të vegjël, i ke mësuar

kur ishin nxënës, i kë stërvitur kur ishin ushtarë, i ke marrë ose i ke pasur vartës në punë, sepse nuk qëndrojnë gjithmonë të tillë, jeta, koha ecën vetëm në një drejtim, përpara. Jo radhë, në bashkëbisedime të zakonshme, sidomos kur ka reagime, kundërshti ose kritika ndaj atyre “ishëve” që mund ta kesh në bashkëbisedim, dëgjojmë shprehje të tilla si: “ty të kam pasur nxënës”, “ke qenë ushtari im dikur”, “të kam pasur në punë kur ishe i ri”, pa menduar, me ose pa qëllim, se njerëzit rriten, shkollohen, mësohen dhe mësojnë, është plotësisht normale se bëhen edhe më të ditur në të gjitha drejtimet. Gati sa nuk i thuhet “na dole i fortë more Gjino”. Debat, kundërshtia apo kritika nuk kanë të bëjnë aspak me mungesën e respektit të ati “ishit” të vogël ndaj ati “ishit” më të madh në moshë apo poste, ndaj respektit për punën dhe marrëdhëniet e dikurshme. Por duhet kuptuar se njerëzit nuk qëndrojnë gjithmonë të vegjël në moshë ose edhe në punë apo karrierë. Koha, jeta dhe zhvillimi janë edhe për ata. Nuk qëndrojmë gjithmonë, fëmijë, nxënës, vartës, ushtarë, punëtorë, “skllëvër”, të cilët mund ti lësh ose të mbeten pa bukë kur të duash, që duhet tu binden urdhrave dhe vetëm urdhrave të një njeriu, sepse është më i madh në moshë, sepse dikur ishte në majë, në karigje, sepse dikur kishte në vartësi të tjerët. Nuk është normale, nuk është në doli të shoqërisë dhe të ardhmes që të tundet me forcë moshë apo marrëdhëniet e dikurshme, puna që është bërë dikur. Është mungesë hapësirë kur ish nxënësi në vegjëli, ish vartësi, ish ushtari, etj. të qëndrojnë i përkulur, kokulur apo me drejtqëndrim përpara ish eprorit të tij edhe kur kanë kaluar mbi 40 vjet ndarje dhe marrja e drejtimeve të ndryshme, ndoshta edhe i dal në pension, të ndjehet nën presion nga megalomania e dikurshme e eprorit, madje ai, ish eprori i dikurshëm, të shikojë e të flasë gjithmonë si nga maja e malit, pa çka se ish vartësi i tij, tani, është shkolluar madje më shumë së ish eprori i tij, pse jo ka fituar edhe gradë shkencore. Veprime si këto nuk krijojnë mundësi hapësire, drite, përparimi. Diskutimi apo kundërshtimi i mendimeve të paraqitura nga ish njerëz me pushtet, ish padronëve, ish eprorëve të dikurshëm, ose ish titullarëve që e mendojnë veten gjithnjë në “komandë”, në “karrige”, pavarësisht ku ndodhen për momentin nuk ka të bëjnë aspak me mungesën e respektit për ata që të kanë marrë përdore dikur, por është koha që sjellë zhvillim dhe nevojën e mendimeve të reja, etj. Naim Frashëri porosiste: “ti mësojmë fëmijët sepse janë për një kohë më të gjatë se ne”. Kjo nënkupton ecjen përpara dhe aspak që gjithmonë ti marrim për dore, tu qëndrojmë mbi kokë, tu diktojmë gjithçka. Respekti reciprok i fituar dikur, marrëdhëniet e krijuar në të kaluarën, janë dhe duhet të jenë shumë të forta, tashmë si partner, bashkëpunëtor, bashkëveprues, bashkërrugëtar. Gjithkush ka nevojë për mbështetje, për nxitje në ide e veprime në të mirë të së ardhmes. Mbatja nën tutelë, mungesa e hapësirës është një shkelje me thundër të fuqishme, për të

mos e lejuar ngjitjen e ish vartësve, ish nxënës, ish punëtorit, ish ushtarit, për të mos lejuar ngritjen në këmbë, ngritjen në karrierë, ecjen në shkencë.

Demokracia është bashkëpunim, është respekt reciprok, por pa cenuar marrëdhëniet dhe të mirën e përgjithshme. Ajo ka rregullat e veta që duhet të zbatohen nga të gjithë po të duam që të bashkëpunojmë me njëri tjetrin. Megjithëse ligjërisht jemi dhe jetojmë në demokraci, a mendohet kujdesshëm për perspektivën, sa mendohet për drejtuesit e së ardhmes, sa mendohet për kuadrot e brezit që vjen. E vetmja arsye, mendoj unë, është mungesa e dëshirës për të pasur mundësi zëvendësimi, që të rrinë sa më gjatë në karrige, në majë.

Mungon hapësira edhe kur zë vend më shumë se të takon, më shumë se të tjerët përbri teja ose paralel me ty. Mungon hapësira kur me fjalë rëndon me çdo kusht tjetrin, shokun tënd, kur u imponohesh të tjerëve duke ngritur zërin, duke u prerë fjalën, nuk ka hapësirë kur me duar, me brryla, duke shtyrë gotat, pjatat, duke hapur këmbët sikur nuk ekziston askush tjetër zë vend më shumë në tavolinë, nuk krijohet hapësirë kur gjatë gjithë kohës ngacmon me dorë krahun e tjetrit ose godet me gju gjurin e tjetrit për ta detyruar që ta kenë vëmendjen vetëm tek ti gjatë bisedave në një rreth shoqëror, në një tavolinë, nuk ka hapësirë kur me ose edhe po të drejtë, pse jo edhe duke vënë në dispozicion paranë në forma nga më të ndryshmet përpiqesh për të zënë vend më shumë se të tjerët, për të marrë më shumë se të tjerët. Mungesë hapësire është edhe mohimi i çdo gjëje. Arsyeja e mos arsyes është mungesë hapësire, është mungesë drite. Mungesë hapësire është edhe kur kërkon të dukesh dhe të shkosh kudo, me rëndësi dhe pa rëndësi, të bësh heroin apo viktimën, vetëm për tu dukur, kur nuk delegon detyra, kur gjithnjë vendosë emrin tënd të parin, pavarësisht kolegëve që ke, deri edhe në nekrologji për të njerëz të vdekur, në lista diskutimesh, fjalimesh a përshëndetjesh. Zënie hapësire është edhe tendenca për tu vendosur gjithkund në reshtin e pare, në tribunë, etj. Mungesë hapësire është edhe qëndrimi arrogant dhe fyes në publik ndaj personave të ndryshëm, qofshin edhe koleg e bashkëpunëtor, dhe individualisht, në ndonjë qoshe, kërkon falje. Vendosja e parasë në shërbim të lavdisë personale kur nuk e meriton krijon mungesë hapësire. Edhe kur bëhen mitingje pa pjesëmarrës, dhe janë më shumë në tribunë se përpara saj duket se nuk ka hapësirë. Nuk është krijim hapësire kur e fton tjetrin në sofër, tavolinë apo tribunë dhe nuk i bën pak vend. Duhet ditur që çdo hapësirë që zë më shumë se të tjerët, i përulë ata, u shkakton dëm të atyre, i shkakton dëm interesit të përgjithshëm.

Ndodhë jo radhë që edhe në ekskursion, në një rrugëtim me ndonjë grup shoqëror dhe duhet marrë me vete edhe një çantë, të paktën, me ushqime të domosdoshme, dikush transporton çantën, dikush ecën duke tundur krahun, duke bërë shaka e duke qeshur, madje edhe me atë që ka mbi shpinë çantën, e lehtë apo e rëndë

ka pak rëndësi, pa pyetur se kush është i ngarkuar dhe kush është bosh, kush kullon djersë e kush nuk nxjerrë një pikë, ose ndoshta edhe për ti larguar vëmendjen nga peshë, bën shaka, apo për tu dukur si i interesuar për shokun, mikun e tij “transportues”, pa i thënë një herë “ma jep mua çantën që ta mbaj edhe unë pak”, pavarësisht se janë bashkë në të njëjtin grup, për të njëjtin qëllim për në të njëjtin vend, dhe kur vjen puna për të ngrënë, ulet i pari, dhe as që i shkon mendja që ta pyes shokun, bashkërrugëtarin, mikun e vet nëse është lodhur. Edhe kjo është mungesë hapësire, sepse është mungesë respekti dhe kur ky respekt mungon pa tjetër mungon edhe hapësira.

Të gjitha mungesat e hapësirës janë në dëm të shoqërisë, por është e “bukur” se të gjithë flasin për krijim hapësirash, mundësisht, për liri veprimi kudo e për këdo, që të ecë në jetë, por këto mbeten vetëm fjalë...fjalë. Shoqëria, komuniteti duhet të jenë i ndjeshme, madje shumë, sepse këto mungesa janë pengesa shumë të fuqishme, janë pengesa që do të sjellin pasoja për një kohë shumë të gjatë në të ardhmen. Nuk është normale që të ngrihet njëri e të ligjërojë si e “ëma e Zeqos në majë të thanës”, tu japin mend të tjerëve, kur në diskutim e tij nuk duket asgjëkund hapësirë, dritë, ndonëse bërtet për krijim hapësirash. Ka njerëz, madje me jo pak shokllë, që kërkojnë, gërmojnë, shikojnë gjithçka më lupë, për të gjetur gabime e të meta dhe për të prodhuar kritika. Bëjnë kritika ata që nuk kanë bërë ndonjë punë të dukshme në atë drejtim, nuk kanë shfletuar ndonjë leksion apo studim, nuk kanë bërë një studim. Këta persona e dinë dhe e mendojnë çdo gjë siç e dinë ata, dhe kështu, sipas tyre, duhet ta dinë dhe pranojnë të gjithë. Po kritika duhet dhe madje e fuqishme, por duhet edhe fjala e mirë, vlerësuese, mobilizuese, mbështetëse. Vrapimi pas të metave nuk të nxjerr në anë. Nuk është krijim hapësirash kur edhe i ngarkon detyrat edhe i dublon pastaj me persona të kur shikohet se po arrihet objektivi për të përfutur atë grimë vlerësim që mund të fitohet. Nuk është krijim hapësirash duke ndërtuar një apart të tërë burokratik shkurësurnash apo dosjesh, natyrisht pa cenuar ato të nevojshmet. “Uni” është fjala që më së shumti mbyllë hapësirat, fik dritën, ndalon zhvillimin. Është shumë e rëndësishme që secili ta kuptojë deri ku e ka hapësirën e vet, dhe se ku i mbyllë hapësirën tjetrit. Mirë është që të rregullohen gjerat me mirëkuptim e bashkëpunim, por nuk duhet harruar që edhe masat shtrënguese demokratike janë në shërbim të krijimit të hapësirave. Kur kalohet nga dhënia e dorës, dëshira e bashkëpunimi, në masat shtrënguese, detyruese, atëherë nuk mbetet më nder por është detyrim, është zbatim ligji. Është sikur në momentin që je duke ngrënë diçka dhe pranë teje është një person i uritur e i jep atë që të teproi. Kjo nuk është nder. “Me çfarë tepron nuk del nder” thotë populli.

Luigj SHYTI

DASHURI E MIRËNJOHJE PËR VENDLINDJEN

BASHKËBISEDIM ME AUTORIN E LIBRIT “DUKAGJINI-SHQIPËRIA IME ATY”, REFLEKSIONE, NDUE SANAJ, KRYETARI I SHOQATËS “ATDHETARE-DUKAGJINI”

Kohët e fundit, z. Ndue Sanaj, i mirënjohur, së paku, në mbarë Shqipërinë e Veriut për kontributin sa publicistik, shoqëror, sa civil si njëri nga ideatorët themeltarë dhe po aq kryetar i shoqatës “Atdhetare-Dukagjini” dhe drejtues i gazetës “Dukagjini”, si një pasqyrim dhe inkurajimi vlerash, të cilat rritin nga dita në ditë autoritetin profesional, social dhe civil të shoqatës në fjalë, del para lexuesit me një tufë refleksionesh si përjetësim i të parit libër publicistik, titulluar “Dukagjini-Shqipëria ime aty”.

Në vend të një refleksioni, kushtuar këtij libri e pamë më të volitshme dhe funksionale, në sytë e dashamirësve të shumtë të z. Sanaj, refleksionet publike të vetë autorit në fjalë, në faqet e gazetës së tij më të dashur, gazetës “Atdhetare-Dukagjini. përmes këtij bashkëbisedimi:

I nderuar Sanaj, përshëndetje! Bashkërisht si dy miq dhe po aq si mik i shoqatës “Atdhetare-Dukagjini” që ju drejtoni prej mbi një dekade, prezantohemi para lexuesit tonë me prezantimin publik, të një lindjeje të re mes nesh, ndryshe të mikut më të madh të njeriut civil, librin, të cilin kësaj radhe do ta thërrasim me emrin e vënë nga ana juaj “Dukagjini-Shqipëria Ime aty”. Sa bukur, pa asnjë paragjykim apo kompleks ndjeheni krenarë deri në shpirt dhe të dashuruar pas vendlindjes suaj! Madje, shkoni edhe më tej me shumë dinjitet duke e identifikuar me vetë Shqipërinë, atdheun tonë të shtrenjtë.

Si u lindi kjo ide nga inicimi, hartimi dhe dalja me këtë emër shumë domethënëse, kur jo pak kanë kompleks të pohojnë dhe pranojnë vetveten, prejardhjen e tyre?!

I nderuar Kadri, faleminderit për mundësinë që më jepni të komunikojë me lexuesit e gazetës “Dukagjini”.

Kam kohë që mendoj të shkruaj, për vendlindjen time, Dukagjinin dhe me anë të këtyre shkrimeve të bëj përpjekje të jem plotësisht pjesë e tij e bashkësisë së tij, për t’u bere pjesë sa më denjësisht në shoqërinë demokratike, në shoqërinë e hapur në themel së cilës janë vlerat e individit, për të pasur mendimin e lire dhe veprimin në bazë të ligjeve të shtetit demokratik. Për të krijuar bindjen ndër veti dhe tek të tjerët se, ne, dukagjinast, kemi se çfarë të sjellim në çdo bashkësi, që mund të jetojmë dhe punojmë, dhe të bëhemi pjesë e tij. Gjithashtu të krijohet bindja se, ne kemi çfarë të marrim tek bashkësia ku kemi vendosur të ngremë çerdhen tone familjare dhe këto së bashku është e mundur të nxjerrin një diçka të re, të përbashkët pa humbur identitetin, në këtë shoqëri. Gjithashtu të bëjmë përpjekje të nxjerrim vlerat tona, që duhen të trashëgohen, por dhe të bëjmë përpjekje të njohim anti-vlerat, të cilat duhet t’i lëmë prapa dhe të mos jenë më pjesë e jona. Qofte nxjerrja e vlerave dhe publikimi i tyre, bërja e tyre pjesë e shoqërisë demokratike, e shoqërisë që jemi, qoftë në hapësirën shqiptare apo dhe në mje-

diset e shoqërisë evropiane, gjithkund që bëjmë përpjekje të jene pjesë e tyre dhe të punës sonë se, kudo kemi se çfarë të tregojmë, kemi se çfarë të japim dhe të bëhen pjesë e tyre, në veçanti përpjekjet tona në shekuj për të qëndruar nacionalitet i pastër dhe të mos asimilohemi nga perandoritë e mëdha që na kane pushtuar me shekuj, për të treguar përpjekjet tona deri në flim të jetës për të mbijetuar në kushtet tejet të vështira deri jashtë imagjinare. Jo vetëm këto dy vlera të mëdha, në ato kushte të vështira të mbijetesës, për të cilat, të paret tanë kane një meritë të jashtëzakonshëm, por dhe forcën e madhe morale për tu vetëqeverisur në baze të drejtës zakonore, pa dallim qoftë për të varfrin apo qoftë për të pasurin, qoftë për nivelin e fundit të malësorit apo qoftë për drejtuesin më të lartë të malësorit.

Kjo mundësi mu dha pasi dola në lirim dhe më vone në pension! Gjithashtu me themelimin e Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini” dhe me nxjerrjen e gazetës sonë, gazetën e shoqatës e pagëzuar me emrin e shenjte “Dukagjini”

Me disa artikuj publicistik në forme analizash, në forme opinionesh dhe në forme të refleksioneve kam bërë përpjekje të paraqes ato mendime, që mendoj se i duhen më shume jo vetëm dukagjinastve, por gjithë shoqërisë demokratike, shoqërisë së hapur në tërësi. Pse kam bere përpjekje? Njeriu duhet të bëj përpjekje të kontribuojë, secili duke kontribuar në mundësitë e veta, ai jep diçka që i shërben shoqërisë. E, ky mendim që tregon se je progresist, më ka bere që të mos i kaloj ditët e pensionit duke luajtur letra apo duke luajtur domino, pavarësisht se, dhe ato janë mjet i argëtimit të njeriut, por më është dukur më e mire të punoj për të tjerët se, në këtë mënyrë ndieja dhe ndiej më shume kënaqësi, ashtu që do të ndjejë dhe në të ardhmen.

Mendova, pasi u konsultova me miqtë e miket mia, Luigjin Shyti, Lazer Kodra, Prele Milani, Arjeta Ferluskaj, Suela Ndoja, Luigj Mila, Ndoc Selimi dhe Lazer Stani, me bashkëshorten, Veneranda (Vera) dhe vajzat (Enkelejda, Edmira e Enveida), këtë publicistike modeste, ta mbledh, ta vendos në një libër dhe ta pagëzoj me emrin “Dukagjini, Shqipëria ime aty” – refleksione, me propozimin e shkrimtarit, fshatarit dhe mikut tim, Lazer Stani.

Nëse, kam bërë mire është merite edhe e atyre që me përkrahën me mendimet e tyre. Nëse, nuk kam bere mire është përgjegjësi vetëm e imja. Por, nëse do të ketë vlera ose jo ky libër, janë vetëm ata që nuk do të “lodhen” duke e lexuar, të japin vlerësimin pozitiv apo negativ.

Z. Sanaj, një ushtarak karriere, me një formim dhe kualifikim profesional si ushtarak, filluar nga Shkolla Ushtarake “Skënderbej”, vijimi në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”, përfundimi i studimeve të larta ushtarake pranë Akademisë së Shtabit të Përgjith-

shëm “Mehmet Shehu”, dhe sot, te dy këto shkolla quhen “Akademia e Forcave të Armatosura”, kryeni dy kurse kualifikimi pranë Akademisë së Trajtimin të Oficerëve të NATO-s në Turqi, ushtroni funksione ushtaraku nga më brilantet, nga komandant kompanie, komandant brigade deri shef Shtabi i Divizionit të Këmbësorisë. Gjithnjë i motivuar, gjithnjë i vlerësuar, madje me disa urdhra dhe medalje si ushtarak dhe po ashtu me disa tituj nderi si veprimtar shoqëror, kryetar i shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, nga “Krenaria e Shoqatës Aleanca Kombëtare e Ushtarakeve”, “Qytetar Nderi i Komunave Pult dhe asaj të Rrethinave-Shkodër deri tek “Mirënjohja e Qytetit të Shkodrës”, ndryshe koloneli, nga një ushtarak aktiv i kompletuar, sot një pensionist, veprimtar prodhimtar nga më të suksesshmit! Si do ta komentoni këtë sukses?

I nderuar Kadri, unë e ndjeje veten mire. Një shprehje thotë: “Ne jetojmë nga ajo që marrim, por e bëjmë jetën nga ajo që japim!”

Kështu ndodh në fakt dhe me mua. Në shkollën ushtarake kam shkuar krejt rastësisht, por u bëra pjesë e saj. Në fillim disa here kam dashtë të largohem, madje dhe kam hipur në makine për të ardhur te shtëpia, por menjëherë i thosha vetes ku po shkoje? Me lëndonte opinionin ndaj prindërve të mi! Zbrisja nga makina dhe kthehesha përsëri në shkollë. Nuk isha mësuar të merrja një note ‘4’, jo më që të merrja notën ‘2’, siç më doli vizatimi teknik në semestrin e pare, të vitit të pare të Shkollës “Skënderbej”, viti mësimor 1958-1959. Erdhën prindërit dhe axha me më pa. Qaja me dënësë para tyre, se nuk mundja t’iu thosha se kam marre një note pakaluese, notën ‘2’. Më në fund jua thashë. Axha e nena me thane, duket se je mërzite shume, lenë ketë shkollë e hajde te shtëpia, ndërsa baba, me tha: “Bir, në qofte se largohesh nga shkolla, kur të vish te ura e Matit (i thoshin atëherë Ura e Zogut, mbi lumin Mat, në afërsi të Milotit), mos e kalo atë, por të biesh brenda, në lume ...!” Kjo thënie e babës, më mbajti në shkollë, mblodha mendjen dhe ju futa studimit ... Në vitin 1962 përfundova shkollën e mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skenderbej”, me rezultate të mira. Menjëherë vijua studimet për oficer në shkollën e bashkuar të oficerëve “Enver Hoxha”, me këtë emër ishte e pagëzuar ajo shkollë në atë kohe. Në vitin 1964 përfundua këto studime dhe dola oficer me gradën N/Toger i klasit të pare. Pra, gjate gjashte viteve shkollë mora mësimet përkatëse për tu bere ushtarak karriere dhe i vendosur që aq sa mora të jap në shërbim të popullit tim, në mbrojtje të atdheut tim, i cili harxhoi aq shume që të bëhesha dikush, për ti shërbyer atij.

Rastësia më takoj të shkoje për studime të larta ushtarake në moshe fare të re, në raport me praktiken e ndjekur për studime të këtij niveli, në moshën 25 vjeç, dhe në detyrën e komandantit

të kompanisë, kur në shkollë me mua, ishin personalitete ushtarake, si Xhemil Çela dhe Misto Çule. Jo vetëm ata ishin në moshe më të madhe se unë, rreth 10-15 vjet, por vinin nga detyra shume të larta në ushtri. Xhemili vinte nga detyra e Shefit të degës së Zbulimit të Korpunit të Shkodrës, ndërsa Mistoja vinte nga detyra e Shefit të degës Operative të Korpunit të Gjirokastrës. Ata dhe të tjerët shoke klase, jo vetëm që ishin ushtarake me eksperience dhe me dije të gjera intelektuale, por ishin dhe njerëz të mire, të komunikueshëm dhe pa asnjë lloje krenarie ndaj të tjerëve. Pra, vërtetë ishin shembull për ne, për më të rinjtë.

Gjate jetës sime prej 45 viteve ushtarake, tete vite shkollë e 37 vite pune, u mundova të marre nga më të mirët, te marre nga koleget dhe eproret më me eksperience e me dije më të thella e të gjithanshme, por dhe të jap ato që dija pa u kursyer në asnjë moment, se vetëm duke zbatuar atë që të jetojmë duke marre, por të jetojmë dhe duke dhënë.

Arsimimi, kualifikimi i vijueshëm është një gjë e domosdoshme, sepse pa arsimim dhe kualifikim të vijueshëm nuk mund të dish se çfarë kërkon gjate ecjes, nuk mund të dish se çfarë është shqetësimi gjate punës, në shërbim të detyrës. Njerëzit që punojnë shqetësohen. Dhe këta që shqetësohen mendojnë se çfarë duhet për të ndryshuar, çfarë duhet për të qene gjithnjë në lëvizje, për të qene gjithnjë në ecje progresive.

Kam bere përpjekje të marre edhe nga kuadrot e terrenit kudo që kam qene, në veçanti në Kelmend nga drejtori i shkollës se Vermoshit Luigj Pepa, nga mjeku i Kelmendit, me qendër në Spitalin e Tamarës, Sadik Ymeri, nga Kryetari i këshillit të bashkuar, Nike Toma, prej fshatit Theth, nga Kryetari i kooperativës Bujqësore të Kelmendit, Ymer Sadiku prej Gruemirës. Por, dhe nga popullit i kësaj zone. Mund t’iu tregojë një moment “Dhashë një kushtrim efektivit rezervist të batalionit për të provuar masat e marra për realizmin e provës së kushtrimit, por nuk u realizua norma e caktuar e kushtrimit. Për këtë, me kryetarin e Këshillit, Nike Tomen shkuam fshat me fshat dhe bëme takim me pleqtë e tyre. Në mes të tjerave doli, se në kohen e pushtimit osman apo pushtuesve të tjerë në çdo fshat ishte caktuar një mal, qe ‘shihte’ malin e fshatit tjetër dhe në ato male behej roje, të cilët me të pare lëvizjet e armikut jepnin njoftimin njeri-tjetrit dhe brenda një ore e gjithë zona e Kelmendit vihej në gjendje kushtrimi, në gjendje lufte ... Në qofte se ndonjë roje shkelte rregullat dhe nuk bënte shërbimin e rojës (vrojtimit), ai dënohesh deri në lëçitjen nga fshati ...”. Takimi na dha shume mësim ...

Ne asnjë detyre nuk jam ngritur me helikopter, siç ndodhi pas vitit 1990. Në atë kohe, radhe mund të kishte kuadro, që në mëngjes ishin komandant kompanie dhe në të nesërmen ndjeheshin në detyra të nivelit të larte, siç ndodhi pas vitit 1990. Pra, kam kaluar nga një detyre në tjetrën në baze të karrierës në rritje

dhe me kurse kualifikimi. Prandaj e ndjeje veten mire dhe kur them mire, them se, gjithçka e kam arrite duke pasur parasysh: Së pari, me aftësi, duke pasur parasysh atë që thotë populli: ‘ Përseshet të mos i leje të mi hane të tjerët’. Se dyti, duke punuar shume pa kursyer asgjë, as dhe familjen. Se treti, duke punuar me ndershmëri. Vetëm gjate viteve 1991-1995 janë bere kundër meje me dhjetëra letra, apo propozime për shkarkime, por në asnjërën letër nuk është shkruar, se ato tri virtyte nuk i kisha ... Me këtë pune arrita ti qëndrojë kohës edhe pas vitit 1990, sepse ndryshe nuk me ndërroinin me ‘mish dashi’. Është e vështirë, që brezat e ardhshëm ushtarake të besojnë, se një N/Kolonel ishte vartësi i dy kapitenëve dhe më vone edhe i një kapiteni 32 vjeçare. Pse ndodhi ajo? Ajo ndodhi se, kisha vendosur të qëndroj në ushtri e ti shërbejë vendit tim pa kursyer asgjë. Me këtë qëndrim u arrit, që në kohen kur po ‘djegësh’ Tirana, me 14 shtator 1998, emërohem në detyrën e Shefi i Shtabit të Divizionit të Shkodrës ... Po të punosh, po të kesh aftësi dhe të punosh me ndershmëri, është e vështirë te të largojnë Pra, ato struktura si dje dhe sot, që me kane nderuar i falënderojë dhe ju jam shume mirënjohës, jo vetëm me çfarë më kane nderuar, por për më shume për vlerat që kane pare te unë dhe për kontributin që kemi dhënë e japim. Unë nuk kam menduar asnjëherë të bëhem njeri i suksesshëm, por kam bere përpjekje të jem e të bëhem i vlefshëm ... Në qofte se ja kam arrite në çdo detyre shtetërore apo shoqërore sadopak, do ta ndjeje veten mire. Dhe kjo e mire, asnjëherë nuk mund të arrihet vetëm. Nuk mund të arrihet pa bashkëpunëtorët apo bashkëpunëtorët, me të cilët nuk e kemi kursyer ndihmën ndaj njeri-tjetrit.

Si njëri nga bashkëthemeluesit e shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, dy fjalë rreth motivit që e solli këtë shoqatë, mes jush, si bashkësi i vendosur në Shkodër në kontekstin e një shoqërie që e respektton, mbështet dhe inkurajon lëvizjen e lirë të qytetarëve të saj?

Me daljen në lirim e më vone në pension, dëgjova një paragjykim për dukagjinasin deri në racizëm, të cilën edhe pse jetoja në Shkodër, puna dite e nate në detyrën ushtarake, në veçanti në ato vite, që pas shkatërrimit të Divizionit të Shkodrës, në Pranverën e vitit 1997, për ta ri-ngritë atë, nuk me lejonte të njihja me këtë qëndrim racist. Çdo e keqe apo krim që ndodhte në qytetin e Shkodrës apo gjetke, në rrethinat e tij, pa asnjë baze paragjykohej dukagjinasi ... E bën dukagjinasiit ... e vranë ata, ose u vranë ata ... e vdhën ata ... e shkatërruan ata ... e të tjera e të tjera. Këto qëndrime ishin te rrezikshme. Duhej shtate here të pyesje tjetrin apo tjetrën që të kuptoje se ai apo ajo është nga Dukagjini, është dukagjinasi. Ky qëndrim, ky mendim, që të kishte frike, të kishte ndrojtje për të treguar se prej ka është, prej nga ka prejardhjen, më bënte të mendoja thelle në vetvete, të arsyetoja me vete, dhe t’i thosha vetes: Si është e mundur, të ndruhej tjetri për të treguar vendlindjen apo prejardhjen e tij?! Është për t’u çuditur, por

po ju tregojë një rast: ‘Shkoja në Tirane me autobus. Isha me një grua në ndenjësset e autobusit. E pyes, se prej nga ishte: Më tha se jam malësore, nga Kelmendi, por banoi në Shkodër. Deri këtu mire. Vijoj pyetjen: A je e martuar? Po, më thotë dhe kam dy fëmijë. Kureshtja më shtyri të vijoj pyetjen: Nga e ke burrin? E kam prej Dukagjini, por ka lindur në Shkodër ... ! Përsëri e sjelle bisedën dhe i them nga e keni burrin?! E kam burrin nga Dukagjini, por ka lindur në Shkodër, - më përgjigjet. I them, mos të kishte lindur burri në Shkodër, por në Dukagjin, a mund të ishte për burrë, a mund të ishte për mashkull ...?! Nuk mu përgjigje dhe me kaq e lame bisedën, se ajo mbërriti në vendin e zbritjes ... Një rast, më thotë profesor doktor Mahir Hoti, në atë kohe Rektori i Universitetit “Luigj Gurakuqi”: Në orën 02.00 të natës, e kishin marre në telefon ... ‘dy dukagjinasi kane shpërthyer konviktin e djemve të Universitetit ... Shqetësohem dhe i them vetes, si është e mundur?! Kam punuar në Dukagjin, dhe nuk më ka ndodhur kurrë një gjë e tille. Megjithatë, shkoj te konvikti ... dhe në fakt doli se, ata hajdute nuk ishin dukagjinasi, por vendas ...’ Pra, dukagjinasi konsiderohej sinonimi i të keqes në qytetin tone, në Shkodrën e kulturës. Atëherë, i thashë vetes, se duhet të bënim diçka. Një nate, shoh në TVSH-në një emision për Shoqatën Kulturorë “Devolli”, një rast tjetër për Shoqatën “Labëria”. Pra, gradualisht mu përforcua mendimi se diçka duhej të bënim ...

Një nate i them mikut tim, Prele Shytani, ngjitu larte (Prela banonte në katin e trete dhe unë në katin e katërt) të pimë një gote dhe të bisedojmë diçka ... Erdhi Prela e duke pire nga një gote raki, i them për shqetësimin tim ‘Prele a mund të krijojmë një shoqatë, të pagëzuar me emrin “Dukagjini”?’. Po, më tha. Atëherë, a mund të krijojmë grupin nismëtar për krijimin e shoqatës? Dhe në këtë grup, nismëtar ishim: Ndue Sanaj, Prele Shytani, Luigj Shyti, Prele Milani, Pale Lera, Mri Kroj, Fran Preçi, Fran Kapaj dhe Zef Nika. Pra, nga secila krahine kishim përfaqësues.

Sigurisht nuk ishte e lehte. U mblodhëm, diskutuam për shume probleme dhe në veçanti për disa mendime, që na pengonin për të ecur përpara dhe që duhej ti kishim parasysh ... Pas shume përpjekjesh, me 6 prill 2003 themeluam shoqatën dhe morëm statusin juridik, nga gjykata e Shkalles së Pare, Tirane, me nr. 666, date 13 maj 2003 dhe pas kësaj, me datën 7 qershor të atij viti, në sallën e Prefekturës (atëherë) bëmë prezantimin publik, statusin e programin e saj. Filluam punën pa u ndalur dhe duke mos u marre me biseda kafeneshe, me ata që nuk janë të zot të bëjnë gjë dhe mundohen të pengojnë ata që punojnë, por duke pasur në themel të punues sonë vullnetarizmin ecëm pa u ndalur deri me sot, me moton “Mos pyet se çfarë beri Dukagjini për mua, por çfarë bëra unë për Dukagjinin”, që sot, me mbështetjen e Këshillit të Bashkise së qytetit Shkodër, fale kontributit financiar të dukagjinaseve të kudo ndodhur, e në veçanti të atyre në Nju-Jork, në qytetin tone, në Shkodër, vendosem dy monumente, atë të atdhetarit Mehmet Shpendi, të cilin e përruam me

datën 16 korrik 2015 dhe në të njëjtën kohe ju dha urdhri “Nderi i Kombit”, dhe atë të albanologut Martin Camaj, të cilin e përruam me datën 15 tetor 2015, me fillimin e vitit të ri akademik.

Mendua se, na duhesh një ‘avokat’ për shoqatën dhe kush mund te ishte avokati me i mire, se gazeta e saj?! Kryesia e shoqatës vendosi te nxjerri gazetën e pagëzuar me emrin “Dukagjini”. Kryesia miratoi rregulloren e saj, duke pasur parasysh katër kode të pa diskutueshme: 1) Nuk do të botohej asnjë artikull në favor të njëres force politike për kundër një force tjetër politike; 2) Nuk do te pranohej asnjë artikull në favor të një religjioni për kundër një religjioni tjetër; 3) Nuk do të pranohej asnjë artikull në favor të një krahine përkundër një krahine apo fshati tjetër; 4) Nuk do të pranohej asnjë artikull që prek njërën apo tjetrën familje. Pra, këto kriterë ishin e janë të padiskutueshme. Megjithatë nuk ishte e lehte. Me datën 30 dhjetor 2003 kemi bere paraqitjen në mendia e në publik numrin e pare të gazetës. Në këtë prezantim ka pasur nga ata, që ju janë mbushur sytë me lot, kane lotuar nga emocionet, nga një diçka, që as mendohej para datës së themelimit të shoqatës ... Në saj të redaksisë së gazetës, me kryetar të saj Prele Milani, me vone Lazer Kodra dhe tani Luigj Shyti, dhe financimit të saj nga 185 kontribuues, e kohet fundit nga Gjergj Leqejza e Ndue Ftoni është bere e mundur të dali gazeta në çdo muaj dhe tani kemi mbërrit numrin 145 të saj. Sigurisht është një sukses i madh, jo vetëm si arritje, por se në të kane shkruar rreth 337 autor të ndryshëm, dukagjinasi dhe jo dukagjinasi, shkodrane, tiranas e deri gjirokastrit, që nga Evropa, nga SHBA e deri nga Australia e largët, sepse te kjo gazete kane gjetur lirshmëri

Ju, suksesin tuaj ja dedikoni po aq sa punës dhe përpjekjeve tuaja individuale dhe me shokë, po aq shembullit dhe mbështetjes që u kanë dhënë Veneranda, shoqja juaj e jetës dhe tri vajzat: Enkelejda, Edmira dhe Enveida. Një koment i mirëpritur nga lexuesi juaj!

Familja, nuk i thonë më kote, se është qeliza baze e shoqërisë. Po, mund të ecet pa qene i shoqëruar dhe i pa mbështetur në punën tende?! Jo, nuk mundet të ecet. E kush mund të jete më i sigurtë dhe më mbështetës se familja?! Askush tjetër. Kështu ka ndodhur edhe me mua! Bashkëshortja Veneranda më ka shoqëruar dhe mbështetur në gjithë jetën tone të përbashkët, në Shkodër, në Kukës, në Has, përsëri në Kukës dhe përsëri në Shkodër. Në përgjithësi, si çdo ushtarak tjetër, kam qene “mik” në shtëpi. Veneranda merrej me të gjitha problemet e shtëpisë. Pra, përveç punës ku merrte rrogën, merrej me punët e shtëpisë, me mirërritjen e vajzave, me shkollimin e tyre ... Nuk mund, të kesh sukses në pune pa një sakrifice të tille të bashkëshortes. Vajzat, me të mbushur moshën e futjes në shkolle, mësonin shume mire, bënë përpjekje të ndihmonin mëmën e tyre, të ndihmonin njëra-tjetrën. Edhe kjo ishte një mbështetje e mire. Pra, kur fëmija mëson në shkolle dhe është i sjellshëm, të lehtëson shume,

sepse nuk ke nevojë të parashikosh kohen e mundshme të punosh me te. A ka gëzim dhe krenari më të madhe, kur shkon në shtëpi pas një lodhje të pallogaritshme në pune, dhe jo radhe edhe pas disa ditësh, gjene harmoni, pritje tere gëzim, përqaftimin e fëmijëve me plote dashur e respekt, dhe në veçanti nuk dëgjon nga bashkëshortja shprehjet: “A, shyqyr që erdhe më në fund more burrë! Pse, unë do të merrem me të gjitha? Fëmijët kane bere këtë e atë ...”. Sigurisht jeta nuk është si në vaj, Ajo ka problemet e veta, por e rëndësishme është mirëkuptimi në mes bashkëshorteve, të kuptojnë njeri-tjetrin dhe ta mbështesin njeri-tjetrin. Kjo, nuk më ka munguar as nga bashkëshortja dhe as nga fëmijët, vajzat, Enkelejda, Edmira dhe Enveida. Edhe sot, që jam në pension dhe bej përpjekje të jap kontributin tim modest në punët shoqërore, kjo mbështetje nuk më mungon. Sot është diçka tjetër, sepse mënyra e komunikimit ka ndryshuar shume. Në darke, në skype me del Aleksandri, megjithëse po bën katër vjet, më thotë mbrëmja e mire gjysh apo a u lodhe sot, apo natën e mire gjysh, sikur fluturoje nga gëzimi, nga malli dhe dashuria për te, por që edhe më jep krah e dëshire që të vijoj punën time modeste. Pra, nuk mund te kesh arritje pa një mbështetje familjare, pa një këmbëngulje në realizimin e ideve apo qëllimin e caktuar, pa një pune për të përbashkuar vështirësitë, që mund të jene objektive apo subjektive dhe pa menduar për tu tërhequr ndaj tyre ...

Z. Sanaj, sipas jush, shteti dhe kanuni si bashkëpunëtorë, të ndarë nga njëri-tjetri përfundimisht, apo në kompromise nga më skandalozët si ato ku zbatues të kanunit sikur i japin direktiva shtetit?!? Madje për turp të zotit, këtyre të fundit, shteti dhe një gazetarë tejet e vlerësuar si R. Xhunga, sikur u trashqafën duke u kërkuar publikisht dhe me solemnitet mendim për kapërcimin e problemeve sociale?!?

I nderuar Kadri, pyetja e juaj është e drejte. Por duhet ditur, se kanuni apo e drejta zakone me ligjet e shtetit demokratik nuk mund të jene bashkëpunëtorë. E drejta zakone i takon një shoqërie primitive, që do të thotë të një shoqërie pa shtet. Kjo situatë, që shteti ende nuk ka marre plotësisht në dore mbrojtjen e shtetasve të vet, ka ngjirë krye një fenomen, qe po të vijojë e shkatërron shoqërinë ... Pra, në këtë situatë, bëjmë përpjekje të japim mendime me shume përgjegjësi. Gjithashtu duhet të dimë se, konfliktet sociale janë të përgjithshme si për gjithë bashkësitë e tjera shqiptare apo dhe më gjere. Ne kemi ndikuar, them për mire, me tematiken e punës sonë gjate këtyre viteve të jetës së shoqatës nëpërmjet gazetës dhe veprimtarive të ndryshme që kemi zhvilluar, nëpërmjet pjesëmarrjes sonë në shume veprimtari që janë zhvilluar nga shoqatat tona si motra brenda kufijve dhe jashtë tyre, si në Tuz, në Rrafshin e Dukagjinit, nëpërmjet Klubit Shqiptar të Medias, të grupit “Aleanca për Jetën” dhe Grupit të Veprimit Lokal “Bjeshkët e Namuna” e të tjera.

(intervistoi Kadri Ujkaj / vijon)

MARTIN, TREGOJU BURRAVE TE SHOSHIT NDERËN TANDE!

Pasi ka bere xhiron e zakonshme me biçikletën e tij të dashur është kthyer në shtëpi në vaktin e drekës. Por jo, drekë nuk hengri më kurrë. Pa bere as eh, as oh brenda 15 minutash ka bërë dergje e vdekje, 81 vjeçar Martin Gjon Suka. Iku Martini, nuk thirre askujt, se shkova. Madje edhe shoqes së shtrenjtë të jetës, i tha nuk kam as gjë veç dua të pushoj. Martin Gjoni, pa të tjera fjalë, dje filloi pushimin e pasosur! Njerëzit bujar, zemërbardhë, besimtarë e atdhedashës si ju meritojnë një vdekje te tillë të porositur nga engjëjt! Sot u nda nga ne, një ndër burrat elegant, me thinja fisnike, me pak rrudha në ballë e në fytyrë që jepnin çehren e një 60 vjeçari.

Sot u nda nga një gojëtar elegant pop-

ullor, një dashurues pasionant i Shoshit, që i lindi kokën, i Dukagjinit e emblemës së tij më të dashur, Shkodrës, ku kaloj vite më të bukura të jetës dhe shqiptarizmit, të cilin e kishte në zemër.

Sot u nda nga jeta një mik i gazetës “Dukagjini” dhe një hulumtues i pasionuar i kulturës popullore të kësaj zone, që e deshi si biri t’atit.

Sot u nda nga ne, një burrë i pashëm i veshur gjithmonë me elegancë, elokuent në t’ shprehur, i thjeshte, gazetar dhe pa rrebe.

Sot u nda nga ne një kavalier plot nure, të cilit bujaria i shkonte pas si hija lisit.

Mënyra se si fliste, si ta sërvierte duke filluar nga cigarja deri tek tryeza e mbushur plot siç e ka pasur zakon kon-



aku i tij mot pas moti, ishin një shkollë e vërtetë bujarie, një kombinim i shkëlqyer i tradicionales dhe bashkëkohores.

Largimi juaj kaq i papritur na befasoi dhe na hidhëroi, se ti nuk ndiheshe fare plak. Sonte Gjon Nika dhe Kolë Nika (baba dhe axha, dy homeriket nga më të fismit e Shoshit, dhe shpiakët me t’shquar të Dukagjinit) jam i bindur se të kanë pritur me krahë hapur. Tregoju babës axhës, gjithë elitës atdhetare, kulturore dhe burrërore të Shoshit, se ti kontribuove që të memorizosh në kujtesën e brezave, duke mundësuar botimin Monografisë “Shoshi”

Të qofte dheu i lehtë! Shpirti juaj u preftë në paqe Marin Gjon Suka!

Prelë Millani

MUZIKA QYTETARE SHKODRANE, KRYEVEPËR E TRASHËGËMISË KULTURORE

ORGANIZOHET EDICIONI I TRETË I “MUZIKA QYTETARE SHKODRANE”

Në Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, me datën 29 shtator 2015, dite e Marte, ora 19. 30 ne mjediset e Muzeut Historik i Shkodrës, në një mbrëmje të vërtetë festive, përmes një organizimi perfekt startoi me plot hijeshi e freski, tinguj e ngjyra, “Muzika qytetare Shkodrane-2015”, si manifestimi më i madh, duke krijuar një atmosferë festive që me të drejtë është një nga shtatë kryeveprat e shpallura të trashëgimisë shpirtërore kombëtare.

Ky aktivitet në këtë edicion solli një risi: Interpretuesit e këngës së vjetër shkodrane nuk ishin më ikonat e njohura nga publiku shqiptar, por një brez i ri këngëtarësh që treguan në këtë spektakël se ky qytet ka një burim të pastër dhe të pashtershëm që mund ta themi pa frikë se tradita e këngës popullore qytetare shkodrane e ka siguruar tashmë sigurinë e saj.

I shkojnë këtij qyteti këto lloj festash, këto manifestime sa të bukura aq dhe kulturore e shpirtërore, siç i ka hije “Ahengut Shkodran” me ritme e hove rinore.

Çfarë kënaqësie! Në auditorin e improvizuar të këtij oborri binin në sy në radhët e para këngëtarë e këngëtare të shquar, elita e këngës shqiptare si: Bujar Qamili «Mjeshtër i madh», Vjoleta Zefi, Mukades Çanga dhe Adnan Bala, që për dekada me radhë e kënduan këtë këngë në skenat e qytetit, në skenat shqiptare dhe e ruajtën të gjallë, të freskët dhe autentike, të cilët në mënyrë miqësore, profesionale dhe të paanshme, bënë vlerësimin për këngëtarin dhe këngëtares më të mirë, duke besuar dhe uruar që të vazhdojë më tej tradita e bukur e interpretimit të këngës popullore qytetare shkodrane.

Ndoshta kjo ishte “juria” e vërtetë e vlerësimit të këtij aktiviteti, pasi ata me kënaqësi dhe një mall të brendshëm duartrokitnin me shumë emocion zërat e rinj që interpretonin në skenë, të sigurtë se kënga popullore qytetare shkodrane



nuk vdes kurrë.

Ai që solli këtë risi ishte profesori i të gjithë këngëtarëve, muzikologu Ferid Bala, idenë e të cilit e përqafoi dhe e bëri realitet Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” me udhëheqës artistik Bardhyl Hysa dhe organizatori Sidrit Lohja.

Në fund juria përmes duartrokitjeve dhe emocioneve të shumta, vlerësuan si zërat më të mirë Jozefina Simonin dhe

Ilsi Ademin për interpretim dhe origjinalitet të lartë artistik këngën popullore qytetare shkodrane.

Fituesit shprehen falënderimet e tyre përmes emocioneve të mëdha duke treguar dashurinë, pasionin dhe vullnetin që kanë ata për këngët popullore qytetare shkodrane.

Këngëtarja e re Jozefina Simoni falënderoi jurinë dhe publikun për vlerësimin që i bënë. “Është një emocion shumë i madh sepse ky është çmimi i parë që marrë. Ku ka më mirë dhe më emocion se me e marrë në qytetin tim me këngët e papërsëritshme të krijueseve të mëdhenj shkodranë u shpreh ajo”.

Këngëtari i ri shumë i talentuar Ilsi Ademi me sy të përloitur dhe i emocionuar nga gëzimi tha: “Kam fituar disa çmime, por për këngën popullore ky është i pari. Jam shumë i nderuar pasi ky vlerësim është dhënë me profesionalizëm dhe me zemër të madhe artistike. Faleminderit jurisë dhe dashamirësve shkodranë.”

Çmimi që fitova në «Ahengun Shkodran» është një vlerësim i madh jo vetëm për mua, por edhe për kolegët e mi

këngëtarët e rinj të Shkodrës, pasi u vlerësua nga një juri profesioniste, e cila zgjodhi që unë të jem përfaqësues i vetes, por edhe i disa artistëve të tjerë në “Ahengun Shkodran” ndërsa Jozefina Simoni të përfaqësoi veten, por edhe kolegët e saj. Urime Jozefina!

Faleminderit Shkodër që e donë rininë artiste kaq shumë! Faleminderit edhe miqve e kolegëve të tjerë pjesëmarrës,

sepse kemi përjetuar disa momente vërtetë magjike dhe të pashlyeshme nga memoria jonë. Edhe njëherë faleminderit!”

Dy fituesit mes tetëmbëdhjetë konkurrentëve interpretuan dy prej këngëve më të bukura qytetare, siç janë: “Për mu pas-ka kenë kismet” dhe “Me dymbëdhjetë mekame”.

Edhe këngëtarët e tjerë të rinj që morën pjesë dhe interpretuan këngë popullore qytetare morën vlerësime më të mira nga juria e organizatorët, por edhe nga publiku që kishte tej mbushur oborrin e shtëpisë muze “Oso Kuka”.

Me këtë rast moderatoria e njohur shkodrane Gentjana Dani falënderoi spektatorët e shumtë, si dhe formacionin orkestral, që evidentuan më së miri talentin dhe vlerat e tyre.

Anton Kaftalli – violinë / Indrit Kodraliu dhe Agron Rexha – klarinetë / Dritan Mlika - kitarë

Fitim Tuzi – kontrabas / Fatmir Mesi – dajre / Andi Unaza - fizarmonikë dhe drejtues orkestre.

Me zërin e bukur dhe të spikatur të këngëtares nga Ulqini, Egzona Salaj, me interpretimin e këngës “Djal i dashtun” një talent i ri, e dashuruar dhe pasionuar me këngën popullore, studente e shkëlqyer për kanto në Shkollën e Mesme Artistike “Prekë Jakova” në Shkodër, e bija e këngëtarit të mirënjohur popullor Gëzim Salaj, e cila për herë të parë merre pjesë në këtë eveniment, që shkëlqej edhe në Festivalin Folklorik Mbarëkombëtar në Gjirokastrë, fituese e çmimit të parë si këngëtarja më e mirë në këtë festival, u mbyll kjo mbrëmje magjike, duke bërë urimin “Ju shkoftë jeta me aheng”.

Kështu u përmbush një dëshirë e organizatorëve, që këngët e bukura të “Ahengut Shkodran” të interpretohen nga këngëtarë të rinj. Sigurisht ka dhe të tjerë që duhet kërkuar për t’i gjetuar dhe mbështetur.

Nga RAMAZAN ÇEKA

VEPRIMTARI QË NUK NGROHIN

- KOMENT -

28 dhe 29 Nëntori erdhën dhe kaluan edhe këtë vit. Përsëri të ndarë, përsëri më dy data për çlirimin e vendit. E këtë ndarje e bën politika. Të tjerët na kanë treguar me dokumente, veçanërisht për çlirimin e Shqipërisë, e këtë na e kanë treguar edhe ata që qenë zbuar nga Shqipëria, pasi këtyre të brendshmëve nuk duam tu besojmë.

Këto festa erdhën e ikën edhe në Shkodër, pa ndonjë ndryshim me vitet e tjera, por me më pak veprimtari, deri aty, sa të mos duket askund në qytet fjala “çlirim” pavarësisht nga data që e mendojnë palët. Fjala “çlirim” ishte shkruar vetëm në një grimcë letër në një veprimtari me veteranët në një sfond në kinema Milenium me 29 nëntor. Datat 28 dhe 29 nëntori si dita e shpalljes së Pavarësisë dhe e Çlirimit të Atdheut janë përcaktuar me ligj. Ose të ndryshohet ligji ose të respektohet ai në ceremoni zyrtare-shtetërore. Shteti nuk është OJF dhe as një komunitet miqesh që don të festojë sipas qejfit. Në qoftë se në vitin 1944 Shqipëria është pushtuar nga një rrëgjim në kundërshtim me interesat kombëtare, ose “pushtuesi më i keq i të gjitha kohërave”, siç u tha në Shkodër me rastin e ngritjes së Flamurit, atëherë të gjendet data e çlirimit, dhe të gjithë të përkujtojmë në një datë. Jemi i vetmi vend, mendoj, që nuk ka një datë fikse sipas ligjit për çlirimin e vendit. Paradoks është edhe dita e shpalljes së Republikës. Republikë jemi dhe datë të shpalljes së saj nuk kemi. Mund të gjenden data për çlirimin e vendit dhe shpalljen e republikës, festa që i kanë vendet e qytetëruara, të cilat e meritojnë të jenë e tilla, ose për ndryshe të shpallet ndonjë datë që ka “merita më pak”, por ti kemi.

Edhe veprimtaria e veteraneve të shumë për të dëshiruar, veçanërisht, në fjalimet e drejtuesve të tyre. Ne kemi pasur ndjenjën se veteranet janë dhe duhet të jenë trima, të thonë të vërtetën veçanërisht për luftën dhe çlirimin e vendit. Ata kanë plagë në trup që edhe sot i mendojnë, por këto plagë u rëndohen kur janë përpara ndryshimit dhe mbulimit të të vërtetave të luftës. Mungon guximi për përmendur drejtues të luftës. Nuk është, aspak, përgjegjësi e partizanëve dhe as drejtuesve të tyre, të cilët çliruan vendin për ngjarjet që rrodhën pas saj.

Veprimtari të organizuara në këtë mënyrë nuk ngrohin.

Luigj Shyti
29 Nëntor 2015

Gegët e Malësisë së Veriut


Carleton Stevens Coon (1904 -1981). Është një antropolog amerikan, profesor i Antropologjisë në Universitetin e Pensilvanisë, pedagog dhe profesor në Harvard, dhe president i Shoqatës Amerikane të antropologëve. Malet e gjigantëve, ose Gegët, është një nga studimet e tij të rracave dhe kulturave të Maleve të Shqipërisë së Veriut



Carleton S. Coon (1904-1981)

Botimi është i pasur me fotografi të rralla të 1929-1930, realizuar në malësitë e veriut të Shqipërisë nga antropologu amerikan, botuar në 1950 në librin “Malësia e Viganëve: studim rracor dhe kulturor i fiseve të Malësisë së Shqipërisë së Veriut...”!

Raca e shqiptarëve ka karakteristika të atilla, që e bëri antropologun amerikan Carleton Coon të kalonte thujse një vit



udhëve të veriut të Shqipërisë. Në fshatrat më të thella të malësisë së veriut, Coon gjeti karakteret që i duheshin për studimet e tij. Ai takonte burra, gra, fëmijë e pleq, duke bërë disa matje të çuditshme, që me shumë gjasa banorëve të këtyre anëve ju dukeshin jashtë mendsh. Ai studioi tiparet e portretit, flokët, gjatësinë trupore, gjymtyrët ... i fotografonte thujse të gjithë malësorët gegë që takonte.

Me aparatën e tij fiksonte portretin ballor dhe profilin. Po ashtu mbante shënime për secilin prej tyre, pas matjeve të hollësishme që ju bënte. Në këtë udhëtim e shoqëronte një mik i afërt i tij shqiptar, të cilin e kishte punësuar si asistent. Ai quhej Stavri Frashëri.

Falë kësaj dysheje, Coon-Frashëri, që qëmtonin karakteristikat e racës shqiptare maleve të veriut të Shqipërisë përgjatë vitit 1929-1930, sot kemi të dokumentuar të dhëna shumë të rëndësishme mbi an-

tropologjinë e Gegëve, të cilat së bashku me studimin e tij dhe një album me foto të zgjedhura që Carleton Coon i botoi në librin e tij “Malësia e Viganëve: studim racor dhe kulturor i fiseve të malësisë së Shqipërisë së Veriut”, botuar në Kembrixh, më 1950.

Coon lindi në Masaçusets në vitin 1904. Studioi fillimisht për egjiptologji



dhe antropologji në Universitetin e Harvardit, degë për të cilat u diplomua në vitin 1925. Në këtë drejtim ai kreu kërkime dhe punoi si asistent dhe profesor në Universitetin e Harvardit. Më tej, po në fushën e antropologjisë, ai dha mësimë edhe në Universitetin e Pensilvanisë (1948-1963). Gjatë kësaj periudhe ideoi dhe realizoi edhe muzeun universitar të Filadelfias.

“Gjatë viteve 1929-1930 Carleton Coon ndodhej në Shqipëri, ku kreu një studim antropometrik mbi 1 067 shqiptarë të dhjetë zonave të Veriut, duke iu matur madhësitë dhe format e trupave të tyre. Ky studim u përfundua në vitet 1946-1947 me ndihmën e komunitetit shqiptar të Bostonit”, shkruan studiuesi Robert Elsie, në prezantimin e fotografive të realizuara nga Carleton Coon.

Puna e tij kishte qenë e tepër e lodhshme, voluminoze, kërkimet të gjata, një punë që në fund duket se nuk i dha autorit frytet që ai priste. Jehona shkencore e punës kërkimore ishte e kufizuar, meqë “pas Luftë së Dytë Botërore, studime të tilla të antropologjisë fizike dhe të tipareve racore u bënë tabu’ apo kishin humbur interes”, sqaron studiuesi Robert Elsie*, duke shtuar se interes të veçantë ngjallin fotografitë që Coon realizoi gjatë udhëtimeve nëpër dhjetë zonat e veriut shqiptar.

Përveç tyre, me mjaft interes janë edhe fotot që mblodhi e botoi nga ana e tij Stavri Frashëri në librin e tij “Përmes Mirditës në dimër”, botuar në Korçë më 1930 dhe në versionin anglisht “Through Mirditë in Ëinter”. Me materialet fotografike të këtyre dy autorëve, studiuesi Elsie ka ndërtuar një album të veçantë, të cilin

e ka promovuar në faqen e tij këto ditë, e prej nga i kemi zgjedhur edhe ne këto ekzemplarë për t’ia prezantuar lexuesit tonë.

Shqipëria e Veriut në vitin 1929

Carleton S. Coon kreu hulumtime antropologjike në Afrikë (Marok 1925, Etiopi 1933), në Lindjen e Mesme, në Ame-

rikën e Jugut dhe në Indi, dhe ishte autor i shumë veprave shkencore dhe popullore. Gjatë Luftë së Dytë Botërore bashkoi udhëtimet e tij shkencore me punën e zbulimit për Zyrën e Shërbimeve Strategjike (Office of Strategic Services – OSS), pararendësja e CIA-s. Gjatë viteve 1929-1930 Karltn Kuni ndodhej në Shqipëri ku kreu një studim antropometrik mbi 1.067 shqiptarë të dhjetë zonave të Veriut, duke iu matur madhësitë dhe format të trupave të tyre. Ky studim u përfundua në vitet 1946-1947 me ndihmën e komunitetit shqiptar të Bostonit dhe rezultoi në botimin e librit të tij: “*The Mountains of Giants: a Racial and Cultural Study of the North Albanian Mountain Tribes* [Malësia e viganëve: studim racor dhe kulturor i fiseve të malësisë së Shqipërisë së Veriut],” Kembrixh 1950. Jehona shkencore e punës së Kunit ishte e kufizuar duke qenë se, pas Luftë së Dytë Botërore, studime të tilla të antropologjisë fizike dhe të tipareve racore u bënë tabu apo kishin humbur interes. Interesant megjithatë kanë mbetur fotografitë. Fotot e këtij koleksioni burojnë nga vëllimi i sipërpërmendur dhe nga libri i asistentit të tij shqiptar, Stavre Frashëri (1900-1965), “*Përmes Mirditës në dimër*”, Korçë 1930, në versionin anglisht “*Through Mirdite in Ëinter*,” Boulldër 2002.

*Robert Elsie (<http://ëëë.elsie.de>, i lindur në vitin 1950), në Vankuver, Kanada, dhe banues në Gjermani, është një dijetar i cili është i specializuar në letërsinë dhe folklorin shqiptar. Ai ka përfutur imazhin pozitiv të Shqipërisë, dhe Presidenti i Shqipërisë e ka konsideruar atë “një shqiptar i mirë” dhe i ka dhënë atij Medaljen e Mirënjohjes më 15 maj 2013. Koleksionin fotografik mund ta gjëni në: <http://www.albanianphotography.net/coon/>

Përkthyer dhe përgatitur per botim nga Mehmet Metaj
(www.albaforest.com)

NJË STUDIM QË THYEN HESHTJËN HISTORIKE 90 VJECARE; “FANOLISTËT MARTIRË TË PUKËS DHE DUKAGJINIT” ËSHTË LIBRI MË I RI I AUTORIT PRELË MILANI

Nëpërmes fakteve të pamohueshme, literaturës së bollshme të para luftës dytë botërore dhe të fshehur qellimisht pas kësaj lufte, nëpërmes kujtimeve të brezit që e per-jetoi këtë drame dhe kangëve popullore për heronjt, autori Prelë Milani ka arritur të na përcjellë e të ndriçojë një nga periudhat më të rrezikshme e më të egër vëllavrasëse në Shqipëri; të një lufte civile të inicuar e projektuar nga vetë mbreti Zog dhe që historia jonë nuk ka shkruar asnjë rrjesht për këtë hakmar-rje primitive që i ka kaluar kufinjt e masakrave serbe dhe te çetnikve te saj në Kosovë.

Jane vitet 1922 - 1923 kur i gjithë Dukagjini pozicionohet fuqishme me grupin demokrat të udhëhequr nga Luigj Gurakuqi , grupimin katolik dhe opozitën muslimane me në krye Xhemal Bushatin. Në ngjarjet e vitit 1924, po-pullsia dukagjinase manifestoi hapur gatish-merinë kundër forcave zogiste dhe hidhet në veprime konkrete në përkrahje të lëvizjes fanoliste me në krye udheheqësit historikë Ndokë Gjeloşi dhe Dedë Thani, lëvizje e cila konkretizohet me fitoren e 10 qershorit 1924. Por nuk ishte thënë të gëzohej kjo fitore, pasi natën e Krishtlindjeve, Zogu me ndihmen e Pashiqit kthehet në fron duke projektuar një hakmarrje të përmasave masakruese per po-pullsinë e pafajshme të zonave Dukagjin dhe Pukë. Ai u bën thirrje përkrahësëve fana-tikë matjanë, dibranë dhe lumjanë, turma të gatëshme për hakmarrje, shkatërrime, vjed-hje dhe përdhunime me në krye te dhunsh-mit Ceno bej Kryeziu, Muharrem Bajraktarin dhe në mbrapaskenë pro serbin Halit Lleshi, të cilët nisin marshimin për në veri në pran-veren e vitit 1926. Vetë Ahmet Zogu e përcjell këtë turmë deri të Ura e Matit dhe mbanë një fjalim luftënxitës kundër kundërshtarëve politikë të tij në Pukë dhe Dukagjin. Në këto ndjekje hakmarrëse vriten patriotët më me emer si Bajram Curri (ne pabesi), varet në litar Gjeolosh Rama, hoxha i Bytyçit, hoxhë Zogu, Turçuk Rama etj. Muharrem Bajraktari kalon Drinin dhe shkretën e bastisë Bytyç, Gash, Krasniqe, Nikaj - Mertur.

Autori Prelë Milani me një penë brilante dhe me syrin e historianit hedh me detaje atë çka ka ndodh në këto reprezalje dhe gjenera-tat shqiptare po kalojnë tre breza dhe akoma nuk ka dalë në dritë e verteta, ajo çka bëri ky mbret kundër popullsisë së pambrojtur , dina-kria dhe harbutria e derdhur me mlllef prej tij.

Autori jep me kompetencë të plotë fakte e ngjarje, vrasje e burgosje, denime e depor-

time, njerëz të thjeshtë e personalitete të vrara, perdhunim të kanunit e zakoneve. Në këtë pushtim të hordhive zogiste nuk mungoi dami ekonomik si çfarosja e bagëtive, prishja e te korrave, vjedhja e arkave të grave e sen-det e kushtueshme, shkatërrimi i pasurive private, bletëve etj.

Janë të panumërt emrat e njerëzëve që koburja ahmetzogiste ua preu jeten, emra që historiani, publicisti e shkrim-tari Prelë Milani i vendos ne altarin e pavdekësisë me këtë studim, të cilin duhet ta lexojë çdo patriot i ndershëm shqiptar pa dallim ideshë.

Vargje të panumerta të këngëve trimërore që populli i ka stampuar në kujtesen e vet janë prezente në këtë punim. Ata kanë përrjetsuar data, vite, heronjë, vende, tradhëtarë e kohë. Të pashembullt janë thënjet e trimava para litarit e plumbit. Ato thënje janë flamur i besës, janë filozofi e trimave, që edhe para jetes që shkimet gjeten kohë për t’u lanë brezave heroiken e pavdekshme të vdekjes.

Perjetësimet që populli i ka bërë her-onjve të vet kanë ardhë të gjalla deri sot:

Mark Milani i Shoshit gjysmen e jetës e kishte kaluar nder lufta dhe së fundi pritet në besë dhe populli e per-jetson: “Ka bien dielli , ka bien Hana / Mark Milan nuk ban ma nana / Se ban nana , as se ka Shoshi

hej medet ç’e pret konopi dhe kanga nuk lë jashtë rrethanat e kapjes “ Si mos t’kenke besa e Zotit, nuk ia pashë shtyllat konopit”. Gjeloş Rama në po-din e shtyllave të litarit i lidhur nuk vdes pa marrë gjakun në një farë mënyre; ai i keput gishtin e dorës me dhëmbë xhendarit që e shau. Gjon Gazulli në fjalën e fundit ngre ko-ken nga qielli e therret: “Rroftë Krishti mbret, Rroftë Shqipëria e shqiptarët”. Mandej vjen Lush Prela në këngë: “Ai Lush Prela ça ka thanë / token e Shalës e paça lanë / mos me shkel tjetër me kambë / për sa t’jetë mbreti n’Tiranë”.

Kështu rresht pas rreshti në këtë liber vijjnë heronjt, burrat e paperkultur të Du-kagjinit e Pukës, hecin në kolonë njëri pas tjetrit në të njejtat gjurmë, në të njejtën vijë duke trashëguar gjakun, besen, trimërinë. Ata shkrinë pranverat e tyre në mbrojtje të familjes, fisit, krahinës e Shqiperise. Edhe pse

heshtja 90 vjeçare bëri punen e vet, ata nuk shkuan gjakupë; nipat e tyne do të dinë ta vene nderin në vend, do të dinë të qetësojnë eshtrat e tyre, anipse kanë kaluar kaq kohë. Drita qe ndezi autori Prelë Milani në këtë liber asht më shumë se një meshë, ma shumë



se një lutje e një qiri mbi vorret e martirve te harruar.

“Fajtorë për mos publikimin e kesaj ngjarje dhe fshehjen e saj - thotë autori - është histo-ria zyrtare e Shqiperisë (zogiste, komuniste dhe post komuniste) me trajtimin cinik dhe heshtjen hipokrite”.

Ky liber është gjamë e vetëtimë , është pasthirmë kundër shurdhësës 90 vjeçare dhe siç thotë autori “ ...është një kazëm gërmuese për gjetjen e një sargofagu ku qëndrojnë të ndryrë në mënyrë misterioze gomila e esh-trave të fanolistëve të martirizuar antizogistë të Dukagjinit e të Pukës”.

Nga gjithë kjo që lexova dhe shtjellon ky liber më duket pardoks mbretërimi hijerëndë i bustit të Zogut në qënder të Tiranës, kur pa-

triotët e vertetë plisbardhë, mëkati i vetëm i të cilëve ishte antizogizmi dhe të menduarit ndryshe, të dergjen pa një citat te koka e var-rit, të humbin pa nje copë leter të shkruar prej brezave pasardhes. Dhe Prelë Milani vazhdon: “ Unë jam gjak i gjakut të atyre mar-tirëve , por sentimentimi nuk ngrihet mbi faktet dhe të vertetat historike të thëna e të pathëna”.

Komunistet dhe kalemxhinjtë e siste-mit nuk lanë gjë pa thënë e shkruar kunder Zogut dhe regjimit tij dhe heshtje e plotë për këtë masakër kolektive që iu bë malësis. Pse?. Është e vështirë të dalë e verteta. Ndoshta nuk duhej atakuar krahu i djathtë H. Lleshi, ku pjesëmarres në këtë mënxyrë ishte edhe Halit Lleshi .

Në vitet 60 - 70’ te shekullit kaluar i kam dëgjuar me qindra herë, prej vua-jtësve që ishin akoma gjallë, bëmat e çetnikëve shqiptarë kundër fshatarsisë së pambrojtur. “Kur na sulmoi Luma” ose “Kur na sulmoi Dibra” thuhej në popull kur ishte fjala për të treguar një kohëmatje të zezë që perjetoi zona e veriut.

Na perket ne brezit të tretë që të ngrejme zërin në kupë të qielles që nderin dhe heroizmin që u pagua me jeten e gjysherve dhe stergjysherve tonë ta vemë në vend. Gjaku i tyre vazhdon të thërrasë edhe sot, por do të thërrasë edhe neser.

Pushofshi në paqe o fanolistë, her-onjë të harruem!

Libri është i ndarë në tre kapituj , ku shtjellohen:

I - Ahmet Zogu vari dhe vrau lulën e patriotëve të Dukagjinit e Pukës.

II - Ahmet Zogu denoi me vdekje e bur-gim pjesën më elitare të inteligjences së Du-kagjinit të formuar në perendim.

III - Ahmet Zogu dergoi në litar , në plumb dhe burgosi me nga 101 vite parikët dhe gjy-qtarët më të shquar të kanunit të maleve tona.

U falenderojmë perzemersisht Ju autor Prelë Milani për këtë material sesibilizues e të patjetersueshëm në sherbim të martirve fanolistë që shuan jeten për atdhe dhe ndi-hmen e madhe që i dhatë historisë së Shqi-perisë!

Pergatite nga

Ndoc Selimi, Milano, 2015

GJERGJ KASTRIOTI - SKËNDERBEU ËSHTË NJOHUR SI MBRET I SHQIPËRISE QË NË VITIN 1458

(vijon nga faqja 3) dhe me vulen e tijë, me të cilën siguron për çdo premtim dhe obligim të bërë, duke u përgjigjur me çfardo shume të hollash, si dhe me të gjitha të mirat tjera, të çfardo natyre qof-shin ato, nga të gjithë personat, kolegjet apo bashkësite, duke mbështetur të përmendurin, shenjtërine e Tijë, zotin tonë, papën dhe Selinë e Shenjtë, shumë të nderuarin Kolegj të Kardinalëve nga Kon-gregacioni i përmendur, si dhe mbretërit, sundimtarët, dhe gjithë të tjerët, që me forcën e një marrëveshje, për të cilën edhe ne jemi shumë të interesuar, siç jemi deklaruar edhe me lartë, dhe të gjitha këto i bëjmë personalisht, prano-

jmë paqen, veprojme dhe marrim nga të gjithë, pa dredhi, duke hequr çdo lloj dyshimi për mashtrim, ndërsa juve, të lartëpërmendurit, të gjithëve dhe secilin, ju vejmë dhe emrojmë, duke dhënë fjalën e sundimtarit (mbretit), duke shprehur devotshmërinë, nderin dhe besnikërine tone, e konsiderojmë si të përhershëme dhe premtojmë, se të gjitha obligimet tona do ti përmbushim.

Duke ju siguruar ju se, veprimet e përmendura, obligimet pa dredhi të gjitha deri në një, për të cilat kemi dhënë fjalën, përmes oratorit (zedhenesit) ose ambasadorit tonë Martin Muzakës, si të pohuara, shqyrtuara, paralajmeruara,

debatuara dhe përfunduara, i pranojmë dhe obligohemi për to.

Dëshminë e të gjithë këtyre, e forco-jmë, duke urdhëruar vulosjen me vulen tonë të zakonshme, të varur. Lëshuar në Rodon, në vendin e Shën Mërisë, në prezencën e dëshmitarëve të ftuar dhe të lutur (nderuar), në prezencën e shume të nderuarit në Krisht, atit dhe zotit Pal, me mëshirën hynjore, kryeipeshkop i Durrësit dhe i krahinës së Ilirikut, dhe të nderuarit atë, Pjetër Dukës, abat protho-sengulator (i betuar) në Aleksandrin nga Moledina dhe shumë të nderuarit vëlla Bardh, prior i Kuvendit të Shkodrës nga Urdhëri i predikuesve (domenikanëve) dhe nuncit apostolik në Shqipëri, shumë të nderuarit zotit Raione Celnicho.

Ne vitin e Krishtit, 1458, indikti i I-te,

ditën e 28 te tetorit. Noteri Grillis firmos boterisht mbreterine shqiptare

Unë, Johannes Borcius de Grillis, prift i l peshkvisë së Durrësit, notar publik me urdher dhe autorizim të mbretit, firmos të gjitha këto dhe secilen, isha prezent, për këtë dhe i lutur, boterisht pohoj dhe firmos mandatin, por meqë isha i zënë me punë, kam urdhëruar që të tjerët ta shkruajnë, e une e kam firmosur me shenjen time të zakonshme, të notarit publik dhe me emrin tim, së bashku me vulen varëse te të lartepërmendurit dhe shumë të ndriturit zot Skenderbe, e kam forcuar besimin, me dëshmine e gjithë kësaj dhe seciles, që është përmendur me lartë.

SKENA DHE TEATRI - PASION IM I PAFUND ...!

BISEDË ME LEONARD HAMITAJ, AKTOR DHE REGJISOR

Kur e njoha Leonard Hamitaj për herë të parë, ishte një njohje e njëanshme, sepse unë shikoja dhe e dëgjoja duke e përcjell në skenë(maj 2014), e ai nuk e dinte se unë jam njëri nga ata që e përcillja çdo fjalë e lëvizje të tij. Natyrisht se s'kishte mundësi të më njihje edhe pse isha i ulur në rreshtin e parë në sallën e teatrit në Kopër të Sllovenisë, pasi ai aktronte e unë mbaja edhe një aparat fotografik në dorë, duke bërë herë pas here foto. Kur përfundoi drama i bëra komplimentet e merituara...

Biseda vazhdoi gjatë darkës së shtruar nga nikoqirët(Shoqata Kulturore ILIRIA-Kopër) që i kemi miq të përbashkët...Kommunikimi vazhdoi edhe pas asaj njohje të parë, pasi shkëmbyem e-malet dhe numrat e telefonit. Gjatë kësaj periudhe kohore u binda se z. Leonard Hamitaj është individ i artit, kulturës, traditës shqiptare edhe pse jeton në migracion, andaj në një nga takimet e radhës nuk e lash të më ik rasti pa e zhvilluar një bashkëbisedim.

Kush është Leonard Hamitaj, lexuesit do të njihen përmes kësaj interviste që e zhvilluam në objektin e restorantit të një bashkatdhetari, fare pran bregdetit në Ankaranë afër Koprit.

Fillimisht iu falënderojë që pranuat të zhvillojmë këtë intervistë. Për lexuesit një profil të shkurtër,se kush është Leonard Hamitaj?

Një falënderim iu takon juve z. Beqir, që më dhatë mundësinë për këtë intervistë. Jam i lindur në Fier, ku jam rritur e shkolluar(fazat e para të arsimimit) si të gjithë bashkëmoshatarët e mi, në ato kushte që ekzistonin(!). Mandej fazat tjera (të larta) të shkollimit i kam vijuar në Tiranë, ku herë pas here kam ushtruar edhe profesionin për të cilin u përcaktova,... Pra, unë vijë nga qyteti i Fierit, Shqipëri dhe prej vitit 1997 jetoj dhe punoj në Zagreb të Kroacisë.

Cili është profesioni i juaj i vërtetë?

Të jem i sinqertë, profesioni im i vërtetë është aktor-regjisor, profesion të cilin e kam në mendje, në shpirt, në çdo qelizë të trupit tim...

Kur keni pasur paraqitjen e parë në skenë?

Paraqitja ime e parë në skenën e teatrit i përket një periudhe relativisht të largët. Ajo e ka zanafillën e vet që kur unë isha në moshën tetë vjeçare dhe u aktivizova në grupin teatral të fëmijëve në qytetin e Fierit, fillimisht në grupin e recituesve. Mandej në grupin teatral të gjimnazit „Janaq Kilica“,etj. Kam marrë pjesë në një seri konkursesh kombëtare teatrale. Më pas studiova në Akademinë e Arteve të Bukura të Tiranës, në degën e Artit Dramatik, si dhe jam specializuar për regjisor pranë Qendrës Kombëtare Kulturore. Pas largimit nga Shqipëria për shumë vite u shkëputa nga profesioni im. Përpara disa vitesh iu riktheva pasionit tim, teatrit me grupin teatral që drejtoj. Aktiviteti im ka qenë shumë i dendur dhe i pandërpre-

rë por edhe i suksesshëm, gjë që me ka dhënë kënaqësi dhe emocione te pafund dhe te paharruara!

Mund ta kujtoni një emocion të veçantë që keni përjetuar në skenë apo prapa skene?

Emocionet e veçanta në skenë janë të shumta sepse çdo shfaqje është për mua, sikur dhe për çdo artist një diçka e re,që sjell dhe emocione të reja. Por ajo që më ka mbetur thellë në mendje, ndoshta jo vetëm mua, por edhe për gjithë të pranishmeve në sallë, është një rast i veçantë pas shfaqjes së dramës „**Dy krisma në Paris**“ nga trupa jonë teatrale „MRËGIMTARI“ në sallën e teatrit të

Kush janë anëtar të kësaj shoqate dhe nga vijnë?

Shoqata jonë teatrale „MËRGIMTARI“ është një shoqatë e re që ekziston prej vitit 2013. Kjo shoqatë ka për qëllim mbajtjen gjallë të gjuhës, kulturës dhe traditave tona shqiptare në diasporë, tradita sa të bukura, po aq edhe të lashta. Këto tradita në migracion kanë specifikën e veçantë! Që këtë qëllim ta realizojmë nëpërmjet vënies në skenë të veprave të ndryshme teatrale dhe spektakleve poetike-muzikore, tërësisht në gjuhën shqipe. Mendojë se jemi të paktet, ndoshta edhe e vetmja shoqatë e mirëfilltë teatrale shqiptare aktive në diasporë. Kjo gjë na e shton akoma më tepër përgjegjësinë



qytetit në Kopër të Sllovenisë, ku zonja e nderuar, gazetarja dhe ish-luftëtarja e lirisë së Kosovës, Leonora Buçinca, e përfshirë nga emocionet, u ngjit në skenë dhe u përul në shenjë respekti përpara trupës sonë. Ky për mua do të mbetet një moment emocional i paharruar...

Ndoshta mund të iu duket pyetje “provokative”; por, megjithatë do të iu parashtojë: Kur migruat dhe pse?!

Kjo është një pyetje të cilës shumë bashkatdhetar të mi do ti përgjigjeshin në të njëjtën mënyrë! Gjendja shumë e rënduar politike që u krijua në Shqipëri në vitin 1997 detyroi familjen time, si-kurse dhe mijëra familje të tjera të marrin rrugë e vështira e të pasigurta të mërgimit. Unë me gjithë familjen e time u vendosa në Kroaci, ku edhe sot e asaj dite jetojmë duke punuar e vepruar.

Ku është dallimi i jetës e aktivitetit në atdhe dhe në emigrim?

Mendojë se për të gjithë emigrantet, jeta dhe veprimtaria jashtë vendit të vet është shumë e rëndë dhe e vështirë, do me thanë aspak e lehtë. Megjithatë, me mund, pasion, vullnet, dashuri dhe sakrificë të panumërta çdo qëllim mund të arihet. Mua për shembull më jan dashur ti kalojë disa vite në migracion derisa iu kam kthyer profesionit tim duke kaluar nëpër shumë sfida...!

Je kryetar i shoqatës “Mërgimtari”.

për një paraqitje sa ma të mirë dhe dinjitoze përpara publikut tonë e më gjerë .Për sa i përket anëtarësimit në këtë shoqatë, ne jemi një shoqatë e hapur për të gjitha moshat dhe profesionet. Kryesorja është që çdo anëtar i saj të ketë pasion, vullnet dhe dashuri për skenën e teatrit dhe fjalën e bukur artistike.

Cilat projekte skenike që i keni realizuar deri më tani?

Projektet tona, duke filluar nga viti 2013, janë të mjaftueshme dhe ajo që është kryesorja të arritura janë artistikisht dhe me sukses të plotë, kështu e ka vlerësuar publiku por edhe kritika. Aktivitetet tona filluan me dy mbrëmje poetike: **“Shqiponjës dua ti ngaj”** dhe **“Rini thuaja këngës”** të cilat u shfaqen për publikun shqiptar në Zagreb. Më pas vazhduam me vënien në skenë të dramës historike shqiptare **“Dy krisma në Paris”** të cilën e shfaqem me sukses si në Zagreb ashtu edhe në Kopër të Sllovenisë në bashkëpunim me Shoqatën Kulturore ILIRIA të Kopërit, shoqatë e cila drejtohet në mënyrë të shkëlqyer nga Z. Heset Ahmeti. Se fundi, vendosem në skenë komedinë e njohur shqiptare **“8 persona plus”**, të cilën e shfaqem me sukses në Zagreb dhe vazhduam turneun tonë në vitin 2014 në Teatrin Kombëtar të Prishtinës, Qendroren Kulturore të Tetovës në Maqedoni, për ta mbyllur përsëri ne 2015 me miqtë dhe bashkëpunëtorët tanë të Shoqatës Kulturore ILIRIA në

Teatrin e Kopërit të Sllovenisë, të cilët i falënderojë nga zemra për gatishmërinë dhe përkushtimin e tyre.

Planet e tua personale e ato të shoqatës, gjegjësisht grupit që drejtoni?

Planet e mia profesionale janë të lidhura me të shoqatës që unë drejtoj, janë të shumta, por edhe të qarta e reale. Përveç vënies në skenë të veprave nga autorët shqiptar e të huaj në gjuhën shqipe. Do të paraqesim në skenë, edhe vepra të autoreve shqiptar të përkthyer në gjuhën kroate, në mënyrë që të na ndjek edhe publiku kroat që të na mundësohet të marrim pjesë në festivalet teatrale të Kroacisë dhe të rajonit. Ne duhet të vazhdojmë me pasion, këmbëngulje dhe dashuri në rrugën e bukur dhe të vështirë të skenës pra si gjithmonë të promovojmë gjuhën e kulturën shqiptare. Unë jam shumë i bindur se edhe sukseset e rezultatet nuk do të mungojnë, sikurse besojë që nuk do të mungojë edhe publiku që për aktorin e skenës është më motivuesi për të luajtur rolin si i ka hije një aktori.

Është me rëndësi se me aktivitetin në migracion jeni të angazhuar e gjithë familja e Juaj, çka është një dukuri e rrallë (!), cila është pjesa tjetër e familjes dhe çfarë aktiviteti zhvillon?

Është e vërtetë, që familja ime është aktive në shoqërinë shqiptare në Zagreb. Bashkëshortja ime Melita Oreshkoviç-Hamitaj, është ekonomiste dhe kryen funksionin e administratores në Këshillin e Pakicës Shqiptare të Zagrebit, si dhe është mësuese e Mësimi Plotësues të gjuhës shqipe, këtë e ushtron në shkollën e qytetit të Velika Goricës, afër Zagrebit, besojë se i kryen në menyrë të mrekullueshme dhe profesionale funksionet dhe detyrat e saj. Ndërsa, djali im Giulian Hamitaj, përveç se është student në vitin e fundit në Fakultetin e Drejtësisë në Zagreb, gjithashtu është edhe kryetar i Klubit të Studentëve Shqiptarë të Zagrebit, klub i cili në tre vitet e fundit të riaktivizimit e ka gjallëruar së tepërmi jetën e shqiptarëve në Kroaci. Do të thoja se e ndjej veten shumë të lumtur dhe krenar me një familje të tillë që kam, dhe këtë do të ua uroja të gjitha familjeve shqiptare kudo që jetojnë.

Duke iu falënderuar për këtë bashkëbisedim,desha të kërkojë se cili është mesazhi i juaj për lexuesit?

Mesazhi im për lexuesit është tepër i thjesht, është mesazh i një shqiptari dhe një artisti njëkohsisht, me tepër është një thirrje që i bëjë publikut tonë, që t' i kthehet sallës së teatrit, sepse është vendi ku ruhet dhe kultivohet gjuha, kultura dhe traditat tona të mrekullueshme. Gjithashtu, dëshirojë ti përsëritet të gjithë lexuesit shqiptar ku do që ndodhen duke iu uruar shëndet e pasion të pa fund!

Nga Beqir M. Cikaqi,
Nëntor 2015

Prekë Sokoli - Intelektual me vlera të gjithanshme



Ai lindi ne fshatin Lekaj në vitin 1934. në një familje punetore, bujare, patriote dhe njerin ndër fshatrat kryesore të Shalës., ku në rrjedhen e historise ka treguar patriotizëm dhe cilësi të vlerave të Dukagjinit. Babai i tij Sokol Gjoni ishte një burrë i nderuar. Për disa vite mbas çlirimit të atdheut, populli i Lekajve e ka zgjedhur këshilltar. Edhe kushrinjte e tij, si Lulash Mala e te tjere ishin burra të njohur.

Preka lindi dhe u rri ne një ambient të tillë në fshatin

Lekaj-Shalë, Në vitet e para mbas çlirimit të vendit nga pushtuesit e huaj filloj shkollimin fillimisht ne konviktin "Tom Kola", në Theth dhe në vazhdim në Shkodër. Mbas mbarimit të shkollës së mesme me rezultate të larta, për disa vite punoj si mësues dhe drejtues shkollash në Shalë. Së bashku me kolegët e tjerë mësues kontriboj për zhdukjen e analfabetizmit deri në moshën 40 vjeç, në zonën e Dukagjinit. Në vazhdim të karrjeres si intelektual, mbaroj dy fakultete të shkollës larte. Ai u dallua për aftësi profesionale. Preka ishte inteligjent dhe tek ai kombinohet mirë inteligjenca intelektuale me inteligjencën emocionale. Si i till ai gezonte respekt nga njerëzit .

Ai u aktivizua dhe punoj në institucionet e shtetit socialist , instruktor të komitetit e Partisë dhe sekretar i Komitetit Ekzekutiv të rrethit Shkodër me se një dekadë. Preka kudo dhe kurdo u tregua i aftë si nëpunës dhe me sjelljet e tij frtoi respektin e popullit.

Në vazhdim punoj si mësues dhe drejtues kryesor në disa shkolla të mesme të qytetit Shkodër deri sa doli në pension. Mbas daljes në pension ai nuk pushoj së punuari si pasardhës veterani. Ai dha ndihmë të konsiderueshme jo vetëm në Shkodër, por edhe në Tiranë, veçanërisht me banorët e vendosur në këtë rreth nga zonat e Veriut. Një drejtim tjetër i punes së Prekës ishte ndërmjetsimi i tij në pajtimin e hasmërive të hershme e të vona, të cilat u ringjallën në këto vite të demokracisë.

Me ndryshimin e sistemit familjarisht emigroi ne Sh,B.A. Për një kohë të shkrutër u sistemua dhe filloi një jetë normale. Në biseda telefonike ai thoshte se: "Këtu në Amerikë u vendosem me strehim punësim dhe kemi kushte të mira. Por ajo që mungon është vendlindja, njerëzit që dua te bisedoj çdo"ditë". Jeta ka përveç gëzimeve edhe hidherime. Fatkeqësisht i vdiqgruaja, Liza. Pas kësaj u kthye ne Shqipëri. Ai jetonte kryesisht tek vajza Nora në Tirane. Shkonte në Velipoje tek vellai Prendi dhe tek motra në Shkodër dhe sigurisht kalonte kohën me njerezit e fafesisit, shoke e miq të cilët ishin të shumte dhe që kishin kënaqësi të qendronin e të bisedonin se bashku.dhe ishte një nga arsyet që nuk u largua me nga Shqipëria.Preka la pas dy djem familjare me banim në Amerikë dhe vajzën Nora, e cila i shërbej gjithënjë deri në momentin e fundit të jetës babait të saj, Prekë Sokolit, me 01.01.2013.

Deshira e tij për tu prehur përjetësisht në Atdheun e tij, sepse siç thotë populli edhe dheu është më i lehtë. U përroll me respekt e dhimshuri nga familja e tij, shokë, miq e dashamirës, të shumtë. U largua duke lënë pas kujtime të pashlyeshme tek njerezit që kanë bashkëjetuar dhe e kanë njohur atë.

Pergatite nga **Martin Çetina, Pjeter Delia**

*** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi ***

ME DORËN E SAJ TË PAGËZOJ HANA

"Fli bir gjumë me andrra të bukura, të pastë nana
U bëfsh njeri i mirë, i ditun e zemër gjanë
Ditën që linde me dorën e saj të pagëzoj Hana
Me ujin e burimeve që ndodhen në këto anë."

Erdhi një ditë dhe vogëlushi u rritë, u ba burrë
Nga zona e Temalit mori rrugën e Shkodrës:
"Po largohem vendi im, nuk do të shoh ma kurrë!
Due të jetoj i lirë në gjirin e ngrohtë të Evropës".

Katedra e Albanologjisë e Universitetit të Munihut
Profesor doktor Martin Camaj lider nëpër vite
Gjuhën pa pushim e"shkriu" talenti i tij prej gjeniu
Për ta "përzi" në "magjen" e vlerave të radha artistike.

"Dranja", "Rrathët", "Midis dy moteve", "Karpa"
Ka margaritarë të tjerë gjigandi i letërsisë tonë
Në pyjet e bjeshkëve të nalta e ka follenë Shqipja
Në kontinentin e vjetër asaj i bani jehonë.

Amaneti i fundit: "Mos harroni kapuçin e bardhë
Edhe atje në Qiell do ti shërbej jetës
Nuk trembet malësori, të vijë kur të dojë me ardhë
Dhashë çdo gja për njerëzit, për dijen dhe të vërtetën."

Luigj Temali

ELEGJI BABËS

Ti, vërtetë nuk jeton
gjynah që je nën dhe
vorri yt lot më "dhuron"
Por këtu je ndër ne.

Fjala jote engjellore
ftyra jote si pranverë
dhe pse ike prej ksaj bote
brenda meje janë përherë

Është e rrallë ndonjë ditë
që për ty unë nuk flas
oh sa shumë të kam pritë
dhe nuk di ,si nuk pëlças

Mendoj se je në Parrisë
sa shumë e meriton
prej vorrit vjen puhisë
vjen e më ngushllon.

Drita ZEFI, HOT I RI

FADIL KRAJËS

I ditur sa historia,
I urtë sa urtësia,
I thjeshtë sa thjeshtësia,
Kapi maja.
I gjerë e thellë në mendime,
Penë e mprehur me guxim,
Emblemë e qytetit tim,
Fadil Kraja.
Drama e tij vërtetë dramë,
Emocion pa fund shpërndanë,
Duke pritur çfarë po ngjanë,
Frymën mbaja.
Me mjeshtri ka ditë me gjet,
Skena të forta dhe plot jetë,
Që shpesh na linin pa fjetë,
Fadil Kraja.

Sa herë shkruan përmbi letër,
Ka cigaren mikeshtë të vjetër,
Sa fik një ndezë një rjetër,
Rreth tymnaja.
Ecën lehtë thua se shkel tokën,
Nëpër rrugët e tua Shkodër,
Vlerë e madhe në trup të vogël,
Fadil Kraja.

Një kafe turke me të pije,
Se merr leksione lartësie,
Dhe mëson ato që nuk i dije,
Gjera të rradha.
Dalin nga rrudhat mbi ballë,
Mendime margaritar,
Enciklopedi e gjallë,
Fadil Kraja.

QAZIM ÇELA



REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

